

3.54-32

T 95

ER I. TUPJA

PËRMES PROVËS SË HEKURT



854-32

795

8

SKËNDER I. TUPJA

PERMES PROVES SE HEKURT

~~46427~~

BIBLIOTEKA E SHITETIT
SHKOLLORIT

3201

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

**Partizanëve që ranë në Luftën e madhe
nacionalçlirimtare, atyre që shkruan epo-
penë më të lavdishme të historisë së
popullit tonë.**

Lexuesve!

Në këtë vëllim të vogël me ngjarje nga epopeja jonë më e lavdishme, Lufta nacionalçlirimtare, përmbledhen disa ngjarje të jetuara në ato vite të provës së hekurt për popullin tonë. Këto janë fletë të shkëputura nga «ditari» i madh i periudhës së luftës. Disa nga këto flasin për njerëzit e thjeshtë që dhanë jetën për popullin, për partinë dhe atdheun.

Ngjarjet janë paraqitur ashtu siç kanë ndodhur, pa zbukurime e tepërime.

Në këto ditë, në prak të 25 vjetorit të themelimit të Ushtrisë sonë heroike, duke botuar këtë vëllim, nuk bëj tjetër, veçse kujtoj traditat e mrekullueshme patriotike revolucionare që u manifestuan në mënyrë aq të pastër dhe aq madhështore gjatë Luftës nacionalçlirimtare, të udhëhequr nga partia jonë e lavdishme, me shokun Enver Hoxha në krye.

Autori

ZEMRA

Nëntor 1967. Natë. Sonte jam vetëm. Në dhomë është qetësi. Jashtë bie shi me rrëshekë. Lapsi shket mbi letrën e bardhë. Herë-herë dora ndalet... S'është lehtë të kthehesh me mendje 24 vjet më parë. Po, 24 vjet kanë kaluar, një jetë e tërë, e vrullshme, e zjarrtë, plot me ëndërra nga më të guximshmet, me mendime dhe ndjenja nga më të bukurat. Rrugën e hapi Nëntori ynë i madh, Partia jonë, me shokun Enver në krye. Gëzimi i çiltër shihet në jetën tonë të re, në sytë e ndritshëm, në hapin e sigurt të njerëzve tanë.

...Nëntor 1944. Eh, si u derdhën në Tiranë luftëtarët e lirisë me kapotat laramane! Përpiqem t'i thërras kujtesës, po lapsi dridhet në dorën që meket. Dobësi?! Ndofta. Penda nuk ka forcë të shprehë atë flakë të pashuar, që digjte atëhere zemrat partizane. Sa rrugë kishin bërë ata për të arritur gjer në Tiranë! Sa «yje të kuq» qenë këputur para se të vinin në kryeqytet!

Erdhi dita dhe ne u futëm në qytetin e dashur, në rrugët plot baltë të periferisë. Banorët na pri-tën si çlirimtarë, si luftëtarë. Nuk do të më dalë nga mendja dora e fishkur e Hamidesë, e kësaj nëne

që ish rrëgjuar më shumë nga ankthi i pritjes, se nga pesha e vjetëve, kur prekte rrobat, fytyrën dhe flokët e Astritit tonë partizan. Ai i shembëllente çuditërisht djalit të saj, që më kot e priste. 28.000 mbetën si kurorë lavdie për lirinë e Shqipërisë. Dhjetra mijë të tjerë lanë një pjesë të zemrave të tyre në rrugët e ashpra të luftës për liri. Kështuqë një pjesë e zemrave tona mbeti edhe në cepat, shtëpitë, rrugicat sheshet e barrikadat e Tiranës së kuqe.

Me që erdhi fjala për zemrën, do t'ju tregoj një ndodhi të shkurtër.

... Në Brigadën I sulmuese të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare njoha një partizan. E quanin Istref. Ishte nga Osoja e Skraparit. Si mbiemër mbante emrin e fshatit. U bëmë shokë të ngushtë; lufta na miqësoi. Vinte pak i shkurtër, po i plotë. Kishte fytyrë zeshkane, sy të zinj si ullinj. Ishte më i madh në moshë nga ne të tjerët. Shokët e donin, se ishte i çiltër, fliste pak e saktë e, për më tepër, qe i drejtë me të gjithë. Vetëm me njërin qe «kapur» njëherë për hiçgjë.

Po ecnim krah për krah me të në një shteg të ngushtë, pas një përpjekje të ashpër me nazistët. Fjalë pas fjale, Istrefi përmendi kushedi për të satën herë atë që edhe ne të tjerët e kishim dëgjuar vazhdimisht. Një shok i tha:

— Istref, ç'është kështu me ty? Na mërзите. Ne e kuptojmë, po më mirë na e thuaj vetë se ku e ke fjalën, kur thua «unë kam dy zemra»!

Ai qeshi, siç e kishte zakon, dhe prapë foli ashtu si më parë.

— Do të vijë dita dhe do ta mësosh edhe ti.

Tjetri u pendua për pyetjen që i bëri, i erdhi ca si inat që Istrefi fshihte diçka dhe seç pëshpëriti.

Kaluan ditët, muajt dhe ne e kishim harruar fare frazën e njohur të Istrefit. Rasti e solli të mësoj më në fund se ç'donte të thoshte Istrefi me fjalët «zemra ime e dytë», të cilën e quante të parë për nga rëndësia.

... Ishte kulmi i Operacionit armik të qershorit të vitit 1944. Ziente lufta. Partizanët jo vetëm qendronin e nuk binin në kurth, po manovronin me shkathtësi dhe kundërsulmonin me furi, aty ku armiku nuk e priste. Kollanët e fishekëve të partizanëve zbrazeshin shpejt, bombat pakësoheshin, duke u përdorur me vend, po armët e tyre, edhe kështu, vlenin gjithnjë më shumë se pajisjet e plota të armiqve. Aq të furishme ishin luftimet në rripin e ngushtë që zbriste gjer poshtë fshatit Shëmbërdhenj të rrethit të Gramshit e që ngjitej gjer lart në Ermenj, sa të dukej sikur vendi ishte ndezur flakë. Natën ndrisnin fushqetat e gjelbra e të kuqe, ndërsa plumbat çanin ajrin si shigjeta vdekjeprurëse. Shëmbërdhenji kaloi disa herë me radhë nga gjermanët te partizanët dhe anasjelltas. E pashë Istrefin gjatë njërit prej kundërsulmeve partizane, që nisi nga një kokojkë e vogël, ku qenë shpërndarë ca gurë që formonin një lloj barikade natyrale. Pasi u err, u dhà urdhëri për sulm. Kompania e Istrefit sulmoi e para në drejtim të fshatit. Pas pak u dëgjuan thirrjet e luftëtarëve të lirisë. Përleshja qe e ashpër. Nazistët qëllonin kuturu me të gjitha armët. Vendi shungullonte i tëri. Qielli dukej si i përflakur nga fushqetat me ngjyra. Granatat plasnin nga të katër anët. Armiku nuk e priste një goditje të tillë të fuqishme. Sa vazhdoi kështu, nuk më kujtohet. Në raste të tilla njeriu e humbet nocionin e kohës.

Po Istrefi ku ishte? Mos kujtoni se kjo pyetje

u bë në mes të betejës. Jo. U bë më vonë. Një partizan i kompanisë së tij na tregoi:

«...Në anë të fshatit nxinte një shtëpi e veguar, me mure pak të prishur dhe me një kopsht të madh plot pemë. Ajo nuk ishte e shkretë brenda. Në të banonin njerëz. Ndofta të sëmure, ndofta shumë të thyer në moshë, ndofta...

Gjermanët nuk mundën t'i qendronin rrebeshit partizan. Njëri syresh e flaku mitralozin dhe briti gjer në kupë të qiellit, kur bomba i plasi në këmbë; tre të tjerë qëllonin qorrazi dhe prapseshin të llah-tarisur nëpër ferra e shkurre, si hije, ndërsa, mbi ta, partizanët dukeshin sikur fluturonin si shqiponja.

Pas pak, shtëpia e vetmuar mori flakë. Përreth u dëgjuan britma, plasën bomba, kërcitën pushka e mitralozi. Nga porta e shkrumuar dolën dy nazistë. Istrefi, që kishte arritur te kopshti, i sulmoi me bomba. Njëri s'pati kohë të fshihej a të ikte, se u qëllua për vdekje. Në errësirën e natës, që skuqte nga flakët e zjarrit, ai u hoq zvarrë përmes kopshtit dhe u fut në shtëpi. Istrefi e ndoqi mbrapa. Pastaj u dëgjuan dy krisma të thata, një rrënkim i thellë dhe shokët që po afroheshin, e panë Istrefin tek doli nga shtëpia. Ishte nxirë ca në fytyrë dhe buzët i dridheshin. Në mollzën e njëres faqe i rrëshqiste një lot i madh i rrumbullaktë.

— Çfarë ke? — i thanë.

Ai nuk foli, po, i tronditur thellë, u ul përtokë, ca çape larg. Mos ju prenë këmbët? Apo ishte plagosur rëndë? Po. Istrefi kishte marrë një plagë mu në zemër. Nuk qe plagë plumbi, por po aq e rëndë.

Brenda në shtëpi, sapo kaloje portën, përbri murit qe shtrirë një nazist me automatikun mbësh-

tetur pas njërit krah. Në krahëror, pikërisht në zemër, dukej një njollë e kuqe dhe e madhe gjaku. Në vatër, një përzierje lëndësh të ndryshme të përzhitura lëshonin ende tym. Në një cep, pranë dritares së vogël, që ngjante me frëngji, dallohej diçka e llahtarshme, që ishte mbledhur kruspull. Ishte e zonja e shtëpisë, e masakruar nga armiku barbar, e cila priste të gëzonte shtëpinë me lindjen e një foshnje. Përmbi kokën e saj, në mur, qenë shkruar me thëngjill këto fjalë: «Partia është zemra jonë». Vende-vende, disa germa nuk lexoheshin. Në anën tjetër të murit ishin gdhendur ca germa të tjera, që dukej se qenë bërë nga një dorë e pastërvitur, ku lexohej afërsisht dhe me vështirësi «Partia është mëma ime». Ndofta këto të fundit do t'i kish shkruar një fëmijë nga të shtëpisë, i cili nuk ndodhej aty. Në dysheme shtrihej kufoma e nazistit tjetër, të cilin Istrefi e kishte tërhequr zvarë dhe e kishte larguar nga muri, sepse edhe ashtu i vrarë i fëlliqte ato gërma. Istrefi nuk mund të duronte që armiku të prekte asgjë, qoftë edhe diçka pa jetë, që fliste për zemrën, tonë të madhe».

Në luftimet për çlirimin e Tiranës e takova dhe ju luta të ma tregonte vetë këtë episod. Ai nuk pranoi, po, ama, shokët tashma e kishin «zbuluar» për cilën zemër fliste ai.

Një, apo dy ditë para 17 nëntorit të vitit 1944, Istrefi ra. Zemra e tij nuk rrahu më. E goditi një shnajper gjerman, jo në zemër, se ai nuk lejonte t'i prekej asnjëra nga dy zemrat.

Kur më thanë shokët se, edhe ashtu i vrarë, njëren dorë e mbante në zemër, m'u kujtua «e fshehta» e tij dhe thashë me vete: «Armiku nuk la gjë pa përdorur për të goditur në radhë të parë

zemrën tonë të madhe, Partinë, si dhe zemrat e luftëtarëve të lirisë, po ato rrahën gjithmonë fort për njëra tjetrën, u bënë një dhe sot nuk ka forcë në botë as t'i vrasë e as t'i ndajë».

NJË DORË MIELL

Dimër i vitit 1943. Bënte ftohtë, frynte erë, binte shi me sqotë.

Nazistët përparonin ngadalë, mespërmes Labërisë; partizanët manovronin me shpejtësi dhe kundërgoditnin orë e çast.

Shenjat e luftës i shihje kudo: te njerëzit, te shtëpitë përdhese me dritare të puthitura mirë, te rrugicat e mbetura shkretë, te bagëtitë e çakërditura e gjer te dëllinjat, që ishin prerë vende-vende si me sëpatë.

Nata na zuri në të hyrë të Mesaplikut. Ishim tre partizanë të një batalioni, shokë lufte, të miqësuar në ditët e provës së rëndë. Njëri, Nevruzi, ishte shtatgjatë, me krahë të fuqishëm dhe me sy shqiponje; tjetri vinte i imët, verdhacuk, po ishte i papërtuar. Të dy shokët, që ndryshonin aq shumë nga trupi, kishin një gjë të përbashkët: hanin shumë. Njëherë rufitën sa hap e mbyll sytë një tas të tërë me qull të nxehtë dhe, për çudi, kokërdhokët e syve as u lëvizën fare nga vendi.

Ecnim në natën sterrë të zezë dhe këmbët shkisinin nëpër baltën e trashë e shtrembëroheshin

kur shkelnin mbi gurë. Do të pushonim aty dhe të nesërmen do të merrnim udhën përsëri. Tërë atë ditë s'kishim futur gjë në gojë e kjo na bënte të shpejtonim çapat drejt një shtëpie të vogël përdhese, ku do të kalonim natën.

Të lagur gjer në palcë, trokitëm në portën e shtëpisë. Përnjëherësh ajo u hap dhe një grua e re na tha të hynim brenda, pastaj mbylli portën. Mbetëm për një çast në këmbë, duke vështruar rreth e rrotull dhomëzën përdhese me dritare të vogla. Në një kënd ishin shtrirë tre fëmijë, më i madhi rreth 5 vjeç, më i vogli motak. Në vatër kishte ca thëngjij të ndezur, që mund t'i mblidhje në dy grushte. Fëmijët ishin mbuluar me ca leckat të holla. Nga porta hynin pikat e shiut, që formonin një vijë të hollë uji, e cila përhapej në truallin e pashtuar.

Në krye të vatrës ishte varur një fotografi, ku dallohej mirë një burrë i pashëm, veshur me kostumin karakteristik të krahinës. Në anën tjetër të dhomës kishte një shtëmbë, një legen dhe një arkë të vjetër. Kjo ishte gjithë pasuria e asaj familjeje.

Ndërsa vështronim këtë pamje të dhimbshme, zonja e shtëpisë, që sillej sa andej këndeje, duke dashur të rregullonte dosido vendin, tha:

— Zvishni palltot dhe hiqni këpucët, shokë, uluni dhe çlodhuni; këtu nuk është mirë, siç e shihni, po na e bëni hallall, se kanë ardhur kohra të këqija; gjene mirë edhe kështu.

— Ti të na falësh, shoqe, se të bezdisëm në këtë natë të vështirë dimri, po kështu na rastisi, — i tha Nevruzi.

— Ç'thoni kështu, more shokë? Labi s'e turpëron kurrë shtëpinë dhe mikun, pa le që për shokët e luftës jep edhe kokën, prandaj zemërohem, ta

dini, — tha grueja me zë të plotë e pak si të vrazhdë.

Hoqëm palltot dhe këpucët, vendosëm pushkët në këndin e dhomës, pas portës, dhe u ulëm në një rrogoz rripa-rripa, që na shtroi e turpëruar.

Jashtë bënte shumë ftohtë, shiu derdhej me grykë shtëmbe dhe era vërshëllente si e marrë. Në vatër thëngjijtë e kuq po mbuloheshin me cipën e hirtë, ndërsa fëmijët mbledhnin këmbët nga që ngrinin.

Njëri nga shokët nxori qesen me duhan dhe na e dha për të dredhur nga një cigare. Bukuria, kështu e quanin të zonjën e shtëpisë, po na vështronte një për një me ata sy depërtonjës, sikur donte të futej thellë në shpirtin tonë, të mësonte ndjenjat tona, brengat, vuajtjet dhe gëzimet, besimin dhe shpresat tona. Njëri nga fëmijët thirri nëpër gjumë, ajo u ngrit, e mbuloi, i përkëdheli flokët dhe, kur u kthye nga ne, psherëtititi thellë:

— Ah, more shokë. I shikoni këta fëmijë? Dy më të mëdhenjtë janë të mitë, kurse i vogli është i sime motre... — Zëri ju drodh, kapërdui pësh-tymën, tundi kokën dhe vazhdoi: — E mora ta rris, sepse motërzeza u vra, kur po ikte në pyll për t'u shpëtuar gjermanëve dhe tradhëtarëve.

Ne rrinim kokulur dhe cigaret na mbetën pa u dredhur.

Bukuria ngriti kokën dhe, duke shikuar në murin për kundruall tha:

— Në atë fotografi atje është burri im; i ziu, më la kur isha e rëndë me të dytin, vdiq papritur. Po u dashka bërë zemra gur, se ndryshe i përlan lumi këta të vegjlit, pa për yete s'bëhem merak fare; rrëmbej pushkën dhe të më marrin të keqen ballistë e gjermanë.

Duke e vështruar ashtu tek fliste me aq zjarr dhe me sinqeritet, thashë me vete: «Kjo grua e thjeshtë labe nuk duhet të ketë këtë fat», po djali i madh, që u çua papritur, ma këputi fillin e mendi-meve.

— Nëno, dua bukë, — i tha ai si i përgjumur.

— Fli, pëllumb i nënës, ja dhe pak zbardh drita dhe nëna do të bëjë për të ngrënë.

Fëmija na vështroi të tre në sy, mblodhi buzët dhe pështeti kokën në jastëkun me xhunga, të mbushur, siç duket, me fletë misri. Aty për aty nuk i kuptuam fjalët e Bukurisë.

Pas pak, ajo u ngrit, vajti në një kënd të dhomës, nxori një qese, në fund të së cilës kishte diçka. Ne pamë që zbrazti nga qeska një dorë miell e filloi të gatuate bukën. Tani kuptuam gjithshka, shikuam njëri tjetrin dhe për çudi e ndjemë veten të ngopur.

— Mos bëj asgjë për ne, — i tha Petriti, — ne kemi ngrënë.

— Mos më gënjeni, sepse sido që të thoni, nga shtëpia ime nuk dilni pa ngrënë, një kulaçe të ngrohtë me nga një kokër qepë. Kjo na ndodhet, më vjen turp, po... — tha zonja e shtëpisë dhe vazhdoi të gatuate.

Petriti deshi të ngrihej, po unë e ndala dhe i dhashë të kuptonte se nuk ishte mirë. Kur hodhëm bishtin e cigares së pestë, gruaja kishte mbaruar së pjekuri kulaçen e vetme dhe bashkë me tri kokrra qepë na e vuri përpara. U zumë ngushtë nga bujaria e saj; na erdhi keq për atë grua, që na priste me bukë e kripë e zemër të hapët; shikuam fëmijët që bënë gjumin e shqerrave e që të nesërmen në mëngjez do të kërkonin bukë, dhe na u mblodh një lëmsh i madh në grykë. Të mos hanim fare, do ta

fyenim; po, a mund të hanim atë kulaç të ngrohtë, kur në trastën e miellit nuk kishte mbetur asgjë? E gjetëm rrugëdaljen: thyem nga një copë fare të vogël, uruam sipas zakonit, i kërkuam të falur për telashet që i nxuarëm dhe pastaj ramë të flemë. Po nga mendja nuk na hiqej pikëllimi i përmbajtur që spikaste në sytë e shëndritshëm të Bukuries. Pas ndonjë gjysmë ore e pashë vjedhurazi atë grua që fshinte lotët me një shami të bardhë.

Në mëngjez u ngritëm herët. Së largu dëgjo-heshin krismat e mitralozit. Siç dukej ishin ndezur luftimet. Përshëndetëm Bukurien, që na përcolli disa çape larg portës së shtëpisë, dhe e ndjemë veten të kënaqur që fëmijët e saj do të kishin ç'të futnin në gojë atë mëngjez.

Shiu binte përsëri me rrëshekë dhe ne shpej-tonim, po përnjëheresh Petriti qëndroi:

— Daleni, shokë, kontrolloni xhepat! — Të trija kapotat tona kishin nga një copë kulaç të ftohtë dhe nga një qepë.

Sikur të kryenim një urdhër, kthjem kryet pas dhe pamë Bukurien që qëndronte në këmbë afër portës së shtëpisë duke buzëqeshur. Pas pak ajo thirri:

— Mos u merakosni, ju duhet të hani, se do të luftoni e jeni për udhë. Partia që mendon për ju, mendon edhe për mua.

Bënte ftohtë, binte shi, po ne ecnim pa ndjerë lodhje dhe uri.

~~46427~~

BIBLIOTEKA E SHITËR

1991/1992

3807

SHOQET TONA TË LUFTËS

Duke zbritur nga autobuzi urban, shikoj një vajzë leshverdhë me pantallona të hekurosura e me xhaketë ushtarake, që i vinte mirë pas trupit. Kjo vajzë e re, ndonja 19 vjeçe, i shëmbëllente shumë njerës nga shoqet tona partizane; prandaj më mbeti në mendje për një çast dhe ja që në kësi rastesh të ngjallen kujtime. Në kokën time u bë kështu një lidhje midis dy brezave të denjë për njëri tjetrin. Kjo ishte edhe arsyeja që më shtyu ta nis kështu këtë tregim për shoqet tona partizane.

Në fillim të luftës ato ishin pak; numëroheshin me gishta. Më vonë, me to mund të formoje batalione të tëra. Lufta çlirimtare i tërhiqte si magnet ngado që ishin dhe ato i përgjigjeshin thirrjes së Partisë njëloj si djemtë, po me ato dëshira të zjarra, po me atë vendosmëri, po me atë shpirt sakrificë.

... Dimër 1943-1944. Binte një dëborë përzier me shi. Era frynte si e marrë. Vargu i partizanëve ngjitej gjatë shpatit të malit, që vende-vende ishte i zveshur. Gjermanët qëllonin nga larg me artileri dhe mitraloza të rëndë. Duhej kaluar ky shpat mali sa më shpejt. Partizanët donin të shtrëngoheshin

pranë e pranë, për të dëgjuar të paktën frymëmarrjen e njeri-tjetrit, sepse u dukej sikur kështu do të ndjenin ngrohtësinë e shpirtit të shokut, të bashkëluftëtarit.

Pasi kishim bërë goxha rrugë, u ndodha afër Zarifit. Isha lodhur e këputur sa s'bëhet. Pak më përpara ecnin dy nga shoqet tona. Këpuçëve të njerës vetëm emri u kishte mbetur, sepse tabanet e këmbëve të saj linin gjurmë mbi borë. Po kje ecte pa thënë asgjë, pa u ankuar. Pak më tutje vinte një pyll, vende-vende me ca sheshe të vegjël. Pa arritur tek njeri prej tyre, krisi pushka e mitralozi. Njera nga kompanitë tona, që e priste armikun nga ai krah, kundërsulmoi me furi. Jehoi thirrja «Përpara partizanë të Brigadës I». Kur dëgjonte këtë emër armiku e dinte se do ta kishte pisk, sepse e kish provuar forcën e saj të madhe goditëse, manovrimin me shpejtësi, shfrytëzimin me mjeshtëri të befasisë, terrenit dhe faktorëve të tjerë që veprojnë në luftën partizane.

Në mes të betejës shquhet një partizan që qëllon pa pushim. Ai është në ballë. Nuk e përfill fare rrezikun. U takon atyre njerëzve që besojnë fort se trimat vriten më rrallë nga të frikshmit. Dëgjohet një plasje bombe. E hodhi po ai partizani me trup të ngjeshur, me shpatulla të gjera, që dukej si një luftëtar i sprovuar. Nga të gjitha anët lëshohen si ortek dëbore luftëtarët e lirisë dhe vendin e mbulon reja e luftës së pamëshirshme.

Pas gjysmë ore, ata dalin nga pylli dhe vazhdojnë rrugën, më të fortë se më parë. Në krye të kompanisë ecën Emineja jonë, partizanja që hodhi bombën, ajo që shihej në ballë e s'e përfillte fare rrezikun.

Shokët e kanë parë atë duke udhëhequr një kompani të tërë. Aty në sheshin e burrave u poq kjo vajzë e re si dhe dhjetra e qindra të tilla, shoqet tona të nderuara.

... Qershor 1944. Luftohet në Shqipërinë e mesme. Duken qartë shenjat se armikun nuk e pret veçse një fund i turpshëm. Sidoqoftë kjo është ende ca si larg.

Njeri nga batalionet partizane të Brigadës I ka gjithë ditën që po lufton. Aty nga orët e vona, përpjekja duket se po mbaron. Armiqtë nuk kanë më fuqi për të përmbajtur sulmin partizan. Po armët e tyre e bëjnë dhe ato punën e vet, vrasin e plagosin.

Atë ditë Thimjo mori një plagë shumë të rëndë. Plumbi i çpoi tej për tej gjoksin. Ky partizan flokëverdhë me trup të madh tani qëndron shtrirë me buzë të thara nga etja, i pafuqishëm të bëjë lëvizjen më të vogël. Pranë tij përkulet lehtë njëra nga shoqet tona partizane, që i ndërron plagën dhe e mjekon si një infermiere me shkollë. I plagosuri herë-herë çel sytë dhe si nëpër mjergull e vështron shoqen tonë, që i duket si nëna, si motra, si dikush nga shtëpia e tij.

E thërrasin «infirmieren» për një punë të ngutshme dhe ajo i buzëqesh të plagosurit, largohet me ato çape të vogla dhe po me hap të lehtë kthehet përsëri. Ai rrotullon sytë bojëqielli dhe diç kërkon me vështrimin e tij të errët, po në dhomë nuk ka njeri. Është nata e tretë që «infirmierja» jonë nuk vë gjumë në sy. Ajo kotet, dremit pranë të plagosurit, po përnjëherë përmëndet, fërkon sytë dhe truri i punon gjithnjë në një pikë, te partizani, te shoku i saj. Në këtë natë pra e mposht lodhja,

pagjumësia dhe tek përgjon shokun e kap gjumi. Ajo sheh ëndërr sikur po çlodhet në një lëndinë plot lule, në mes të së cilës gurgullon një burim aq i kthjelltë sa uji duket si kristal. Përnjëherë ajo lëkundet e tëra dhe vjen në vete në një kohë me zhurmën që bëri një trup i rëndë, që kish lëvizur gjer në qoshe të dhomës. Partizanja hidhet në këmbë, klith me një britmë të shkurtër e të çjerrë dhe i rrëmben të plagosurit paguren me ujë, që ndodhej në fund të dhomës. Ajo nxjerr shaminë e saj, e lag dhe me të njom buzët e thara të partizanit. Sytë e Thimjos tregojnë një dashamirësi të përzier me ankim. Po vajza jonë e qetëson me vështrimin e saj, në të cilin duket qartë kujdesi i madh për jetën e tij. I plagosuri rënkon, mbyll sytë, i hap përsëri dhe buzëqesh lehtë. «Infermierja» e merr këtë gjest për falënderim dhe lehtësohet edhe ajo.

Pas ca ditësh i plagosuri u bë më mirë dhe, kur i tregoi doktorit për punën e pagures me ujë, ai i tha hapur se, po të kish pirë, do të kish vdekur.

... Në batalion e dinin të gjithë se Asimi ishte shëndetlig. Për higjje ftohej, e mbyste kolla dhe duheshin ditë të tëra që ta merrte veten. Shokët përpiqeshin, sa e lejonin kushtet, që ta ruanin nga sëmundjet.

Një ditë, pas një marshimi të gjatë, partizanët, të lagur gjer në palcë, muarën urdhër që të pushonin. Në shtëpinë përdhese, në krye të fshatit, hynë katër partizanë dhe njëra nga shoqet tona. Një ndër të pestët ishte dhe Asimi. Ai qe bërë si mi i lagur; kollitej dhe dridhej nga të ftohtit. «Infermierja» e «urdhëroi» të zhvishte menjëherë rrobat dhe të ndërronte të brendshmet.

— Nuk kam të tjera, — i tha Asimi.

— Hajde, hajde, hiqi shpejt se e rregullojmë atë punë!

Ajo hyri në të ndarën tjetër, ku rrinin gratë, dhe pas pak doli që andej duke mbajtur në dorë një rrobe që nuk dallohej mirë se çfarë qe, këmishë apo fanelë, dhe ja dha partizanit. Ajo i hodhi pastaj një leckë të thatë për të fshirë kokën. Hapi çantën e saj dhe nxori një palë çorape të arnuara me kujdes dhe ja dha edhe këto për të zëvendësuar të tija.

Shoqja jonë hynte e dilte nga dhoma e grave dhe i rregulloi edhe dy shokë më ca gjëra të vogla. Më vonë solli një legen të vjetër që rridhte, e mbushi me ujë të nxehtë dhe i tha Asimit të fuste këmbët që i ishin bërë akull. Ai e vështronte partizanen me aq dashamirësi, sa ajo e qortonte me shikimin e saj, sikur donte t'i thoshte: «Ne jemi shokë lufte dhe unë nuk bëj asgjë që s'më takon...»

Të zotët e shtëpisë sa s'e përpinin me sy shoqen tonë të shkathët dhe çuditëshin me kujdesin e madh që tregonte për shokët e saj, sikur të ishte motra e tyre.

Natën, kur partizanët flinin, ajo u muar me arnimin e rrobave të tyre dhe të nësërmen në mëngjez u futi në xhepat e kapotave nga një ftua të vogël, dhuratë e zonjës së shtëpisë.

Këto ishin shoqet tona partizane, «infirmieret» tona. Ato nuk kishin thinja, por lufta i kishte pjekur para kohe, i kishte bërë motra e nëna dhe luftëtare.

Sa nga shoqet tona partizane ranë në luftë! E kush nuk e njihte Floreshën, atë vajzën e re 16-vjeçare, ezmerkën syzezë që të mirrte gjak në vetull me trimërinë e saj! E kositi kosa e luftës në

lulen e rinisë në Dibër, tek sulmonte në ballë kazermat gjermane. Po Neta! Më kot e pritën partizanët e batalionit. Ajo mbeti bashkë me shokët e tjerë të preparojës në çastet aq të vështira, aty në Qarishte.

... Ajo vajzë leshverdhë që e takova në autobuzin urban dhe shoqet e saj u ngajnë aq shumë partizaneve tona, nënave të tyre që kanë luftuar, baballarëve të tyre. Po ta kërkojnë Atdheu, Partia ato janë gati të mbushin radhët e batalioneve të popullit tonë për të përsëritur atë që bëri brezi paraardhës, atë që bënë nënat dhe etërit e tyre.

NJËSHKOLONA PARTIZANE

Ishte një kohë, kur fjalët: «Njëshkolona partizane» përmendeshin kushedi sa herë në ditë. Atëherë në shtigjet malore dredhonte vargu i gjatë partizan, që ngjante si një zinxhir laraman nga veshjet shumëngjyrshë. E ky varg njerëzish të armatosur ecte e ecte, ngjitej e zbriste, pushonte, merrte udhën përsëri, luftonte...

Nuk ishte një grumbull dosido njerëzish. Në njëshkolonën partizane fshihej një botë e tërë ndjenjash dhe mendimesh, në të digjej një zemër rinore, që çante mospërmas dallgëve të egra të luftës, rrugën e së ardhmes.

E sot më del përpara sysh përsëri ashtu siç ishte atëherë: hijerëndë, e freskët, e dashur, me një bukuri të ashpër. Po, të gjitha përmbledheshin në njëshkolonën partizane të cilën edhe kur ecte ashtu, herë e qetë, si deti në një natë vere, herë rrëmbyer, si përroi që zbret me vërtik nga mali, e kemi dashur me forcën e shpirtit të revoltuar, ashtu siç kemi dashur bukurinë e ashpër të çdo gjëje të atyre viteve të provës së rëndë...

Shkurt 1944. Njëshkolona partizane kalon Shkumbinin dhe gjarpëron nëpër shtigje gjatë shpateve

të maleve plot dëborë. Janë 500 të rinj e të reja që formojnë tre batalione të Brigadës I sulmuese. Vend i panjohur, dimër i egër, pa ushqime, reaksioni i armatosur gjer në dhëmbë, nazistët nuhasin të etur për gjak, po njëshkolona ka një qëllim fisnik, prandaj gjarpëron e heshtur në natën e zezë, shket me shpejtësi dhe me kujdes, gjithmonë e gatshme të lëshohet mbi armikun, ashtu siç dinin partizanët.

Bën ftohtë. Edhe këpucët me qafa të ndonjërit fillojnë të qullen nga dëborë. Ecën vargu i gjatë e i pangrënë, kopsiten xhaketat e shkurtëra e kapotat e lagura e plumb të rënda nga duart që dridhen. Të bezdisin rripat e çantave rreth krahëve. Po vargu dredharak ecën e ecën, lufton me natyrën që e ka kundër, me urinë, me armikun...

Eh, si është gatuar njeriu! Të mundon diçka dhe ndjen dhëmbje, të ndodh një e keqe më e madhe, atëhere e harron dhëmbjen e parë dhe përmbledh forcat për të përballuar të dytën. Kështu uri vargu i luftëtarëve, po përpiqet të harrojë. Taullai përtyp me gëzim një koçan misri, të mbetur prej kushedi sa kohe. Nevruzi ecën duke u lëkundur dhe herë pas here vështron me bisht të syrit e bën buzën në gaz. I afrohem dhe e pyes çfarë ka. Ai fut dorën në xhep dhe nxjerr një grusht krunde të përzierë me lloj-lloj fundrinash dhe i kapërdin sa çel e mbyll sytë.

E vështroj shokun me një ndjenjë të çuditshme dhe filloj të kem edhe unë uri. Të gjithë kemi stomak të fortë, po goja qëndron e kyçur dhe sakaq fillojnë ato dhëmbjet e mprehta, që të shpojnë si me turiele dhe zorrët që kërcasin, sikur këndojnë. Këmbët futen në dëborën e qullur; ato janë skuqur, djegin, po gjersa truri urdhëron, çapet ndje-

kin njëri tjetrin. Jo, nuk thonë kot se vullneti shemb malet.

Ja tek duken «slitat» e para të njëshkolonës: janë copa dërrase e drunj të rastit, e mbi to këmbët e enjtura të dhjetra shokëve; ndërron pamje e njëshkolonës, po përmbajtja mbetet po ajo: shpirt i paepur partizan.

Papritur, Meti, partizani gjithmonë gazmor e i dashur, hedh edhe një çap përpara, po sytë i erren, sheh një si vijë të gjelbër, që sa vjen zmadhohet, fytyra i zverdhet dhe bie në dëborën e butë. Eshrefi, që ecën përpara, kthen kokën pas, kollitet dhe pyet shokun. E kuptojmë menjëherë shkakun, duam ta ndihmojmë, po me çfarë? Njëshkolona ecën e ne të tre mbetemi pas.

Kaluan vetëm pak minuta dhe Eshrefit i ndritën sytë, futi dorën në çantë dhe nxori një copë të vogël buke. Ja zgjati shokut, po në çast e zuri kolla dhe dy pika gjak njomën krodhën e thatë të bukës...

I shihja si ngulmonin që atë copë bukë ta han-te ai, që ishte më i sëmurë. U kënaqën vetëm kur e ndanë përgjysmë. Pas pak u nisën krah për krah për të arritur njëshkolonën. Dëborë binte dhe, në gjurmat që formoheshin, kuqëlonin pika gjaku...

Natë. Kapakët e syve rëndojnë si plumb. Përpigemi të kthjellohemi, po është e pamundur; sytë mbyllen pas dy tri çapësh. Oh, kjo e keqe e madhe! Fusim kokën në dëborë, e ndjejmë të ftohtit, po sytë durojnë çdo gjë, vetëm pagjumësinë jo. E çuditshme.

Duke ecur, dëgjoj përpara zërin e trashë të Pirros:

— Ja, në atë kthesë ka një fshat, do të qëndrojmë, do të hamë... do të flemë...

Nata nxin. Pas meje ecte Selmani, i hequr në fytyrë, po që duronte në heshtje. Kur dëgjoji fjalët plot shpresa të Pirros, i ndritën sytë dhe tha:

— Sa mirë, pak bukë dhe gjumë, vetëm gjumë. . .

Ja dhe kthesa, po përsëri gërxhe, asnjë fshat.

— Po ti, tani e gjete kohën të bësh shaka? —
i tha Selmani Pirros.

— Ç'farë shakaje?

— Na the se këtu është një fshat.

— Unë? Jo, mor shok, mos pe ëndërr?

Pirroja bënte be e rrufe se nuk kish thënë asgjë. Dhe ne e besuam. Ai kishte folur duke fjetur. Kjo ngjante me atë që ndodh në shkretëtirë, kur syri të sheh një oaz, që nuk është, po që zemra e kërkon me ngulm.

Koha kalonte, njëshkolona ecte. Pas pak u fut në një luginë të thellë. Përkundruall dukej një fshat me shtëpi të mbledhura. Mitralozi kaloi dorë më dorë. Ndërkaq Abduramani u pengua në një gur dhe Eshrefi, që ju kujtua diçka, pyeti:

— Kësh e di nga ju çfarë dredhi përdor Abduramani, që zë gjithnjë një kënd të vatrës, kur fute mi në ndonjë shtëpi?

Me të vërtetë, ky shok nuk mbetej kurrë pa zënë njërin cep të vatrës. Ne e kishim bërë zakon që ai që hiqte këpucët më parë dhe çlirohej nga plaçkat e tjera më shpejt, kishte të drejtë të ulej në vendin më të rehatshëm, në njërin cep të vatrës, ballëpërballë me të zotin e shtëpisë.

Abduramani dëgjonte e qeshte, duke zbuluar dhëmbët e bardhë. Asnjëri nuk i kish rënë më të «hilesë» që përdorte shoku. Të gjithë u habitën kur Eshrefi na tregoi se ai i zgjidhte lidhësat e këpucëve në rrugë e sipër, pranë shtëpisë, se, kur futej

brenda, i mbetej vetëm t'i jepte njëherë thembrës së këpucës me majën e këpucës tjetër për ta nxjerrë sa çel e mbyll sytë e pastaj të ndodhej në kënd të vatrës.

— A më të lumtë! Hajde i mençur ç'na e paske hedhur kaq kohë, — tha njëri nga shokët. Plasi të qeshurit, po qysh atë mbrëmje Abduramanin e vështronin dhjetra sy dhe ai nuk e zuri dot më këndin.

Ja përsëri njëshkolona merr rrugën e nisin edhe ëndërrimet rinore. Sikush e përfytyron të nesërmen me ngjyrat e fantazisë së tij, të gjithë po e farkëtojnë atë me duart e tyre, me pushkën e tyre, me shpirtin e tyre nëpër udhët e luftës së ashpër për liri.

Shpesh prisheshin radhët e njëshkolonës partizane. Kjo ndodhte kur fillonte përleshja e atëhere të gjitha mendimet, të gjitha ndjenjat shkriheshin në një të vetme: në ndjenjën e fuqishme të dashurisë së dlirtë e të thellë për atdheun, për partinë, për popullin. Ky ishte ligj e njëshkolona zinte shtigjet, majat, lëshohej furishëm mbi armiqtë, kacafytej, lante me gjak çdo pëllëmbë vend e kudo lëshonte filizat e reja të së ardhmes.

Sa herë e kanë parë atë me radhë të prishura! Edhe atë pas dite të vrëjtur, në të dalë të dimrit të vitit 1944, sapo la pas Qarrishten, rreshtat e saj u prishën. Në qafën për kundruall, që ish i vetmi shteg kalimi, lëviznin hijet e armiqtve. Qindra sy shikuan komandantin e, kur vendi gjëmoi nga fjalët: «Në sulm partizanë», njëshkolona u përhap, ju ngjit faqes thikë përpjetë. Ja dhe qafa u arrit e përsëri ecën vargu i gjatë partizan. Sa herë e ka nisur rrugën me më pak luftëtarë, po udhës njëshko-

lona i plotësonte radhët e saj me gjak të ri, rritej, bëhej më e fortë, më e re, gjithmonë më e re...

Ishte një kohë kur në «Njëshkolonën partizane», në këtë varg pa mbarim njerëzish, përmbledhej një jetë e tërë, jeta e vërtetë; ishte koha e provës së hekurt.

E sot, duke kujtuar njëshkolonën partizane, na shkon mendja te epopeja jonë e madhe, te lufta jonë çlirimtare, e cila është dhe do të mbetet e gjallë brez pas brezi, si dëshmi e fortë e vendosmërisë së popullit tonë për të jetuar i lirë, si dëshmi e dashurisë së tij të pakufishme për udhëheqsen e urtë e largpamëse, për partinë, që, me shokun Enver në krye, e prin në rrugën e ndritur të socializmit dhe të komunizmit.

QYTETI I DJEGUR NË FESTE

Do t'ju tregoj për një ditë të shënuar maji të vitit 1944, për një ditë me diell të nxehtë e me qiell të kaltër... Atë ditë ndodhi një ngjarje që ngrohu edhe më shumë zemrat e njerëzve tanë.

I ashpër ishte gëzimi ynë atëhere, pa freski; lufta e pamëshirshme e shkatërronte, u thante zemrat nënave, linte gjurmët e saj aty ku kalonte, po partizanët luftonin si heronj dhe, midis tyre, kish-te edhe shumë të vegjël në moshë, që, në vend të çantës së shkollës, mbanin pushkën. Kështu ndodhte atëhere, kjo ishte shprehje e vendosmërisë së një populli për të fituar lirinë e grabitur.

...Në prak të 24 majit, në qytetin e Përmetit, të djegur disa herë nga fashistët, kishte më shumë gjallëri. Nëpër rrugët kalonin njerëz të armatosur, me yje të kuq në kapelat ushtarake. Fytyrat u ndrisnin nga gëzimi, sytë u shkëlqenin, në zemrat u digjej një zjarr që nuk pret veçse të shpërthejë dhe të nxjerrë ndjenjat e çiltëra të njerëzve që kishin braktisur çdo gjë dhe luftonin për një gjë: për lirinë e shtrenjtë.

Qyteti oshëtinte nga këngët partizane, dukej si një kamp i vogël luftarak, ku e ardhmja, besimi

në fitore shihej te të gjithë, në çapet e tyre burrërore, në bisedat gazmore, në gostitë e thjeshtë dhe aq origjinale të partizanëve, në ëndërrat e guximshme të tyre, në dashurinë dhe vëllazërinë midis njerëzve. E të gjitha këto i jepnin një pamje tërheqëse qytetit që priste delegatët nga të katër anët e atdheut. Ata do të merrnin pjesë në kongresin, që hyri në historinë e vendit tonë si një ngjarje e madhe, si një fitore e rëndësishme e popullit tonë.

...Atë mbrëmje, në prak të ditës së shënuar, tre partizanë të Brigadës V sulmuese kishin vënë përpara një shportë me qershi e po hanin e qeshnin, sikur të ishin njerëzit më të lumtur në botë. U afrova më shumë për të shijuar ato qershi kokërmëdha, se sa për të dëgjuar bisedën që bënin. I mbaj mend si tani fytyrat e tyre të skuqura dhe sytë plot gjallëri po nuk kam për të harruar atë që ndodhi më pas.

Si u afrova fare pranë, njëri, që dukej më i ri (do të ishte rreth të tetëmbëdhjetave), m'u drejtua me këto fjalë:

— Eja, o shok, provoi njëherë këto qershi, se po ta bëjnë me sy, apo jo?

Nuk bëra naze, zgjata dorën në shportën e madhe, mora një grusht qershi dhe fillova t'i ha. Madje harrova t'i falnderoj. Pas një minutë, kur u mata t'i pyes se kush ishin, erdhi një vajzë partizane leshverdhë, e bëshme, me rroba të hekërosura e të pastra. Ecte kokulur dhe sytë i ndritnin. Sapo u afrua nja 7-8 çapa i tha njërit prej tyre:

— Hysni, hajde një çikë këtu, se kam një fjalë.
— Ai që quhej Hysni, hoqi dorën nga shporta dhe, nën vështrimin e dy të tjerëve, bëri për nga vajza.

Pas ca u largua pa folur, duke shpejtuar çapin. Partizani që më ftoi, i tha shokut:

— Do të ketë ngjarë diçka e rëndësishme me siguri, po ne qysh mbetëm si hunj e nuk na u dha të pyesnim?

— E ç'bëhesh merak dhe ti, kushedi se ç'punë kanë, — i tha tjetri. Sidoqoftë, të dy u ngritën e shkuan pas shokut.

Shporta me qershi më mbeti mua, po më erdhi turp të haja vetëm. U ngrita edhe unë; e ndjeja veten të shqetësuar. Ç'të kishte ngjarë? Këtë e mësova pas ca kohe.

Të nesërmen ishte 24 Maji i vitit 1944. Agimi i purpurt skuqi horizontin; rezet e diellit dalngadalë u varën poshtë dhe qyteti luftarak ndriti, po më shumë shkëlqeu nga ngjarja gazmore. Pranvera sikur hyri në zemrat e njerëzve dhe u shkri me krenarinë e ligjshme të të gjithëve për kongresin që, me vendimet e tij, e çonte vendin në rrugën e çlirimit kombëtar e shoqnor. Dhe, kur nga salla e kongresit foli udhëheqësi i dashur, brohoritjet jehuan larg. E si të mos gëzoheshin për ato që po ngjanin! Ishte populli që vendoste për të ardhmen e tij. Atëhere kjo ngjarje kishte një kuptim të madh, mbasi tregonte se fati i atdheut nuk vendosej në sallonet plot shkëlqim, ku strukeshin tradhëtarët, po në fushën e betejës. E, në këto vite luftë, forca e zemrës u mat me guximin e heroizmin, që u treguan më të fortë se çeliku armik.

Ndërsa qyteti luftarak jetonte si në ditë feste, armiqtë, fashistët gjermanë dhe tradhëtarët e brendshëm, thurnin plane të reja për të sulmuar Ushtrinë tonë Nacionalçlirimtare. Po ato që u vendosën në Kongresin historik të Përmetit e shtuan edhe

më shumë guximin partizan, e shtuan edhe më tepër besimin e popullit në fitore. Kudo brigadat partizane u hodhën në luftë me forca të përtëritura.

Ditën e fundit të qendrimit në qytet ne, partizanët, ndjenim atë emocion që ndiejnë njerëzit që duhet të kalojnë nga një ambient në një tjetër, nga një gjendje shpirtërore, në një tjetër. U larguam nga qyteti historik plot ndjenja të bukura. Pas disa ditësh dolëm përsëri në shtigjet e luftës. Erdhën edhe ditët e fundit të operacionit armik të qershorit. Në kollanët e shumë partizanëve kishte mbetur nga një ballë fishekë. Një mbrëmje erdhi urdhëri të largohemi nga pozicionet. U nisëm në heshtje. Pas pak filloi një e përpjetë e lodhshme. Si kaluan dy orë, dualëm në Qafën e Dardhës (zona e Beratit). Aty, në një shesh të vogël, takojmë partizanë të Brigadës V. Përnjëherësh më vajti mendja të shporta e qershive dhe hodha sytë andej këndeje se mos shihja Hysniun ose njërin nga dy të tjerët, po ata s'ishin aty. Në këtë kohë u dëgjua boria, që i lajmëronte partizanët të ishin gati. Pas pak ata u rreshtuan dhe filluan të largohen. S'm'u durua dhe pyeta disa syresh.

— Për shokun Hysni e ke fjalën ti, shok? — u hodh e tha një partizan i shkurtër dhe, pa pritur t'i përgjigjem, shtoi: — I kishin vrarë të vëllanë, po mora vesh se e kish marrë hakun aq bukur, sa s'bëhet. I qe prishur gjaku, net të tëra nuk kish vënë gjumë në sy, gjersa kish groposur nja 7 a 8 nga ata derra gjermanë. Vetëm pastaj sikur ish qetësuar ca, po natën shihte ëndërra të këqia...

Tha dhe diçka tjetër, po boria që filloi të bjerë përsëri nuk më la t'i dëgjoja. Mbaj mend se, kur e shënova këtë ngjarje të jetës partizane në fletoren

time të zverdhur nga koha, diç nënvizova. Nuk di pse më bëri shumë përshtypje ai djalë i ri dhe pse për shumë ditë fytyra e tij s'm'u hoq nga sytë; ndofta sepse armiqtë nuk donin ta linin të qetë as në çastet e gëzimit partizan, ndofta sepse ja bënë farmak edhe atë grusht qershia të kuqe. Kështu ishte lufta.

Ne, partizanët, që patëm fatin të ndodhemi në qytetin e djegur, ku u mbloodh kongresi i Përmetit, ruajmë kujtime gjithfarësh. Kalon koha dhe shumë nga këto kujtime mbeten gjithmonë të qarta e skaliten përgjithnjë në mendjen dhe zemrat e njerëzve.

TRAKTI

Sapo kishte hyrë pranvera. Atë vit, dimri po ikte me vonesë e, megjithatë, nëpër rrugët e qytetit të vjetër shiheshin njerëz, që më shumë mbanin xhaketa e rrallë kapota e kapardina. Nuk vinte re askush se si vishej njëri apo tjetri. Ishin vite të pushtimit të rëndë fashist.

Në një rën nga këto ditë pranvere, në orën 18,30 në rrugën kryesore, që kalonte pranë Grand-Hotel (sot Hotel Turizmi) ecte një djalë i ri. Vinte pak i shkurtër, po me trup të ngjeshur. Fytyra rumbullake kishte një ngjyrë gruri si më të verdhë, me sy të zinj dhe pak të futur përbrenda.

Kalimtarët nuk shikonin asgjë të veçantë te ky djalosh, i cili në pamjen e jashtme dukej si student ose nëpunës, që sa po kish mbaruar shkollën. Kështu, pra, ai nuk tërhiqte aspak vëmendjen e të tjerëve. Megjithëkëtë, po ta vështroje me kujdes, do vije re se ai djalë ishte plot pasion, plot guxim dhe kishte plot besim për detyrën që do të kryente.

Ai ecte përsëgjati rrugës, duke shikuar me vëmendje çdo lëvizje të njerëzve. Kur kaloi pranë një porte ngjyrë kafe, brenda së cilës bënte roje një karabinier, i ngadalësoi hapat dhe vështroi me

kujdes. Vuri re se brenda në oborrin e asaj ndërtese kishte shumë ushtarakë fashistë. Kjo i pëlqeu djaloshit dhe, ashtu i shkujdesur, vazhdoi rrugën gjer te kthesa ku ishte fabrika e cigareve «SAIDË». Pasi shikoi orën, vazhdoi rrugën më tutje e pastaj u kthye. E pa edhe një herë orën dhe nisi të shpejtojë çapin.

Djaloshi nuk kishte më atë qetësinë e mëparshme. Zemra i rrihte shpejt, po nuk vështronte as majtas, as djathtas, dukej i kujdesshëm.

Te kthesa, aty pranë fabrikës, mori frymë thellë, shtrëngoi në dorë diçka që krisi lehtë në xhepin e djathtë dhe u ngjit në trotuar, Në rrugë kishte pak njerëz. Dëgjohej shkoqur të kërciturit e këpucëve të tij me shollë. Kur po afrohej te porta ngjyrë kafe, një oficer fashist sapo hyri brenda. Nuk kaloi asnjë minutë dhe djaloshi e la pas portën, ndaloi për një çast, dëgjoi të qeshurat e ushtarakëve brenda në oborr, pa vendin e zbrazët, ku ish e hequr një tullë në murin e lartë që rrethonte oborrin dhe, sa çel dhe mbyll sytë, flaku brenda një tufë me letra, të cilat era i përhapri andej këndeje.

Po tani çfarë të bënte? Ai e kishte menduar çdo gjë. U fut me të shpejtë në Grand-Hotel, ku shkonte vetëm aristokracia e qytetit. Në krye të sallës së madhe dy burra luanin bilardo. Njëri la stekën dhe shkoi në bufe. Djaloshi kapi stekën e tij dhe nisi të luante karambol, ndërsa aty pranë tre karabinierë pyetnin italisht në kishin parë ndonjë njeri të futej aty me shpejtësi. Djaloshi me një italishte të pastër u thotë fashistëve se nuk kish hyrë njeri. Partneri i tij mbeti i hutuar dhe, vetëm kur u larguan karabinierët dhe fill pas tyre edhe

djaloshi, e kuptoi dredhinë. Kur u kthye burri që kish vajtur në bufe dhe i tha shokut të tij të vazh-donte të luante, ky ju përgjigj:

— Dale njëherë të pi një kafe, sa të mbledh veten.

Djaloshi doli në rrugë dhe shpejtoi hapat. Pasi u fut në rrugicën nja 50 metra afër sahatit, ja dha vrapit dhe brenda pak minutash arriti në shtëpi. Ngjiti me të shpejtë shkallët e gurta, përshkoi ko-ridorin dhe hyri në kuzhinën e vjetër. Përpara i doli e ëma një grua e shëndoshë, e cila, megjithëse ishte plot 60 vjeç, nuk kishte veçse një rrudhë të vogël në fytyrë.

— Çfarë po bën këtu? — e pyeti djali.

Nëna nuk i dha asnjë përgjigje, po shtrëngoi edhe më shumë duçka që mbante në gjë.

-- Shpejt, m'i jep të tjerat! — foli djali.

— Aman, bir! A duhen shprëndarë medoemos edhe këto sonte?

— Mos më vono, nëqoftëse nuk do që të më dëmtosh. M'i jep shpejt të tjerat!

E ëma nxori nga gjiri një tufë me letra. Djali u largua dhe porta e vjetër kërciti prapa krahëve të tij. Ai vrapoi nëpër rrugicat e lagjes Kala dhe do-li për dy minuta nga deriçka e kishës së madhe të vjetër. Pas 20 hapash u ndodh në kthesën që merr-te nga e majta. Pikërisht aty ngrihej një ndërtesë e ngushtë. Nga porta e jashtme hyhej në një kori-dor të errët, nga ku ngjiteshin lart një palë shkallë të vjetra prej dërrase, të cilat, pasi bënë një kthesë, të çonin në një sallon të ngushtë e pak të gjatë. Kjo ishte mensa e disa oficerave fashistë italianë.

Djaloshi s'e bëri të gjatë, po u fut përnjëherë

brenda, nxori tufën me letra dhe u mat të ngjitej lart. Në atë çast dëgjoi zëra dhe u struk prapa shkallëve. Pas disa sekondash hynë brenda dy ushtarakë që, duke folur dhe duke qeshur, nuk vunë re asgjë, ndërsa djaloshi ndjente si shkelnin këmbët e tyre nëpër shkallaret mbi kokën e tij. Kur hapat e tyre nuk u dëgjuan më, ai s'e bëri të gjatë, po përnjëherë u ngrit nga vendi dhe ngjiti shkallët dy nga dy.

Rreth tryezave të gjata kërciste vera dhe bifteku. Fashistët ishin në qejf, flitnin me zë të lart, këndonin. . .

Në çast ata panë në krye të shkallëve një njeri, i cili thirri në gjuhën e tyre: «Poshtë fashizmi, roftë komunizmi» dhe hodhi mbi ta një tufë letra. Ndodhi një rrëmujë, që s'e mori vesh i pari të dytin. Shumica e oficerëve kujtuan se mbi ta u hodh ndonjë bombë dhe, duke dashur të futen nën tryeza, rrëzuan dhe thyen shishe e pjata që e shtuan rrëmujën e bënë një zhurmë aq të madhe, sa që ishte dëgjuar në rrugë. Djaloshi kërcëu nga 5-6 shkallë përnjëherësh dhe u gjend në rrugë. Mori kthesën, po në çast dikush zbrazi revolverin. Siç duket qëlloi i pari nga fashistët, që e mblodhi veten më shpejt, Ky plumb, i zbrazur kot, vinte si kofini pas të vjelit. Ai tregoi se diçka nuk shkonte mirë për ata zotërinj, kurse për popullin që një shenjë që tregonte shqetësimin, frikën dhe pasigurinë që mbretëronte midis pushtonjësve.

Me t'u afruar te deriçka e kishës, djaloshi vu-ri re një burrë, që e vështroi me dyshim. Atëhere ai futi dorën në xhep me aq rrëmbim, sa i panjohuri nuk priti të shohë çfarë po nxirrte, po ja dha vra-

pit. Tani vraponin të dy, po në drejtime të kundërta.

Vetëm kur u hap porta e madhe e shtëpisë dhe u fut brenda, djali mori frymë thellë. Kur ngriti sytë përpjetë, pa te shkallët nënën plakë, që kish-te kryqëzuar duart në gjoks dhe ishte bërë dyll e verdhë.

Paniku që kish mbërthyer fashistët italianë dhe shërbëtorët e tyre ishte i madh. Ata bridhnin rrugëve si të tërbuar, ndërsa nëpër zyrat e tyre kërcisnin telefonat, dëgjoheshin sharje, kërcënime...

Të nesërmen, kur Spirua i tregonte Tomorrit dhe shokëve të tjerë ç'i kish ndodhur një ditë më parë, ai qeshi lehtë dhe i rrahu krahët. Në fytyrën e Spiros nuk dukej asgjë tjetër përveç kënaqësisë që sjell kryerja e detyrës.

PRANË SHOKEVE TË RËNË

Duke shkruar këto radhë, mendja më shkon në vjetët e provës së rëndë, në vjetët e luftës, dhe kujtimet ringjallen, më rrëmbejnë dhe sikur ndjej përsëri qetësimet, mallëngjimet, gëzimet, hovet e zjarrra të rinisë, që i fali atdheut ditët më të bukura.

Jam ulur pranë tryezës, në dhomën e ngrohtë e të heshtur, ku ndjehet vetëm tiktaku i sahatit. Xhamet e dritareve janë veshur nga avulli i nxeh-të, po unë sikur kam të ftohtë. Mendja më ka fluturuar në ditët e janarit të acartë të vitit 1944, në ngjarje të dhëmbshura, që nuk mund të harrohen.

... Ishte natë, një natë pa hënë, pa zhurmë, aq e qetë, sa të thoshe se ditën nuk kishte ndodhur asgjë. Kjo qetësi sikur donte të na ngushëllonte, të na çlodhte pas luftimeve shumë të ashpra të ditës, kur Tenda e Qypit kish shungëlluar nga gjëmimi i topave e i mortajave, kur mbi kokat e partizanëve të batalionit të tretë të Brigadës I sulmuese kish shpërthyer shrapneli dhe kishin vërshëllyer plumbat duke çarë ajrin e ftohtë.

Të vrarë kishin shumë më tepër nazistë, po edhe nga tanët flitej se i kalonin të dhjetët; dhjetë parti-

zanë që shtriheshin pa jetë në tokën e ngrirë amtare, të cilët plumbi i këputi në lulen e rinisë, si një degë lisi e praruar që bie e prerë nga sëpata. Ata nuk e ndjenin më acarin e dimrit, po, ashtu të shpërndarë nëpër shkurret e vogla, pritinin e pritinin...

Atë natë, grupi i vogël i partizanëve u var tatë-pjetë Tendës së Qypit për të marrë disa nga shokët që kishin rënë. Nuk ishim më shumë se 7 a 8 vetë. Ecnim në heshtje, me veshët e ngritur për të dëgjuar edhe zhurmën më të vogël. Nata nxinte, në tokën e bërë kallkan kërcisnin këpucët e ndonjërit, se shumica kishin opinga. Kishim të ftohtë. Përpara ishte armiku, ndofta aty, fare pranë, në kokojkën e rrumbullaktë, veshur me shkurre të vogla. Përreth dergjeshin shokët tanë të luftës.

Oh, sa ftohtë, sa ftohtë që bënte atë natë! Pylli dukej më i errët, drurët sikur ngjanin me njerëz që lëviznin, në veshët tanë sikur dëgjoheshin pëshpëritje të mbytura dhe ne ecnim ngadalë, me pushkët dhe granatat në dorë, drejt shokëve pa jetë, ndofta drejt vdekjes.

— Qëndroni, këtu është shtrirë... — tha njëri nga ne dhe fjala ju këput në mes. Atëherë të gjithë formuam një rreth të vogël, ngritëm fundin e kapotave laramane dhe një çakmak lëshoi dritë të zbrehtë në natën pisë të zezë. Dikush u përkul mbi të vrrarin. Në çast drita u shua; shoku e ndezi përsëri, po drita prapë u shua; të tretën a të katërtën herë flaka e vogël lëshoi një dritë të kuqerremtë në fytyrën e të vrrarit, po era s'na la ta shikonim mirë.

— Më duket si Sotiri, — u hodh e tha njëri nga shokët me zë të ngjirur.

— Mua më ngjet me Pirron, kundërshtoi një tjetër.

Një shok tjetër, duke i rënë me bajonetë tokës, u ankua:

— Sa e fortë qenka, e shkreta, ka ngrirë fare, sikur tërë natën të rëmosh, zor se arrin të bësh një pëllëmbë vend për ta.

Ktheva kokën për të fshehur lotët, po më kot, sepse asnjëri nuk mund t'i shihte në atë errësirë, dhe thashë me vete:

«Një pëllëmbë vend, po, një pëllëmbë vend në tokën tonë për shokun, në buzët e të cilit ka ngrirë vdekja. Ç'brenjë! Po lufta është luftë, ajo ka ligjet e saj, të cilave nuk mund t'u shmangesh. Në cilën luftë nuk është skuqur toka me gjak?»

Ndofta atë çast, duke qenë pranë shokut të vranë, secili nga ne mendonte diçka, ndjente se si i këputej një pjesë e zemrës, deshte t'i thoshte atij që s'na shikonte më se shokët janë me të, gjithnjë me të dhe se kishin ardhur aty për të mos e lënë vetëm, për ta shpënë atje në majë, te batalioni i tij, te kompania e tij, nga e cila u shkëput papritur.

Oh, sa pak kohë kishte për të menduar atë natë! Na pritnin të tjerët; kushedi ndonjëri mund të ishte gjallë e na kërkonte. Bëmë përpara dhe unë po e ndjeja më shumë të ftohtin. I thashë një shoku nëse kjo ndodhte vetëm me mua, po ai më tha se mbërdhinte shumë edhe vetë. Ne kishim të drejtë. Në kësi rastesh, zemra e shqetësuar nuk i bënte dot ballë temperaturës nën zero të atij janari.

Ecnim në errësirën e natës, me duar të ngrira nga acari, ndaleshim përpara kufomave që ndeshnin këmbët, mblidheshim tok, njihnim shokun, pastaj

ecnim më tutje, ndërsa ndjenim veten gjithnjë e më të emocionuar.

Kur ja, pranë një shkurreje të vogël, këmbët e një shoku takuan në të butë. U formua shpejt e shpejt rrethi i vogël dhe në dritën e çakmakut njo-hëm... një armik të vrarë, një goxha nazist me një vrimë në ballë. Plumbi partizan e kish goditur aty ku duhej; më tutje pamë një tjetër, pastaj të tretin, të katërtin...

Filluam të ktheheshim e të merrnim të për-pjetën bashkë me shokët e vrarë. Më vonë i va-rrrosëm në heshtje. Pushkët e lamtumirës nuk u dëgjuan, po ata tani ishin midis shokëve të tyre.

Pas pak rrija në një llogore të cekët natyrale dhe po kujtoja shokët e mi të luftës që ishin ndarë përgjithmonë. Më dukej sikur jetonin përsëri me ne, sikur të nesërmen do të sulmonim përsëri bash-kë, do të çlodheshim pas luftimeve, do të hanim atë copë bukë të fortë, do të bënim shaka, do të ngacmonim njëri tjetrin; pastaj do qeshnim. Më dukej sikur do të takoja Ganiun, Mefailin, Sotirin, gjithë shokët e mi e, në çaste të qeta, do të thurnim ëndërrat tona, ëndërra të mëdha, të bukura, ën-dërra partizanësh.

Ndofta kështu mendonin edhe shokët e tjerë. Mos vallë na ishin dobësuar zemrat? Jo, ato ishin prekur mjaft, vuanin, ndjenim hidhërimin që sjell vdekja e shokut, e mikut, e vëllait që ke pasur pranë në çastet më të vështira të jetës. Jo, kjo nuk ishte shenjë dobësie, shenjë ligështie, po shenjë e dashurisë për shokun e armës, për atë me të cilin ndave hidhërimet e gëzimet, çdo gjë të vogël, po të thjeshtë, të kohës së luftës. Heshtja dhe mendi-met tona nuk ishin vajtim, po përmbledhje forcash

për shpagim. Zemrat sikur digjeshin nga flaka e urrejtjes për shkaktarët e të këqijave të luftës e kjo urrejtje shpërtheu si vullkan të nesërmen. Gjaku i shokëve të rënë u bë dritë për partizanët, që u vërsulën me tërbim mbi armiqt e mallkuar. Për një të rënë, dhjetë armiq; kjo qe hakmarrja jonë.

Ranë shokët tanë të luftës, po armiqtë nuk kulan, u prishën planet e tyre. Katër ditë e katër net u gozhduan në vend e kjo ishte shenjë që tregonte forcë, që tregonte se për popullin tonë liria dhe dashuria për atdheun janë më të shtrenjta se jeta.

... Shikoj orën; është mesnatë, po unë nuk kam gjumë, kujtime të këtilla nuk i shlyen dot as koha.

NE BURG

Atë ditë të 8 gushtit 1942, një sy i stërvitur mirë do të dallonte se, në mëngjez herët, në rrugët kryesore dhe në qendër të Elbasanit, po përgatitej diçka jo e zakonshme. Lëvizjet, sidomos në mes të qytetit, ishin më të shpeshta. Nëpër rrugë shiheshin më shumë të rinj që ecnin, siç ecnin ata që kanë për të kryer një punë të rëndësishme.

Po afrohej ora e caktuar. Te sheshi i Bezistanit (kështu quhej atëhere vendi në mes të tregut) filluan të kërcasin qepenat e dyqaneve, që mbylleshin me zhurmë të madhe. Me një shpejtësi të çuditshme bashkoheshin njerëzit dhe grupe-grupe drejtoheshin te sheshi përpara ndërtesës së prefekturës për të bërë një demonstratë të madhe që, megjithëse u quajt demonstrata e bukës, kishte karakter të theksuar politik antifashist.

U mbajtën fjalime të zjarra, u hodhën parulla të fuqishme antifashiste. Në mes të demonstruesve u futën xhandarë e karabinierë të armatosur. Atëhere filloi përleshja. Fashistët italianë dërguan forca të tjera dhe, pas dy orësh, duke qëlluar edhe me pushkë, mundën t'i shpërndanin demonstruesit, po këta ja arritën plotësisht qëllimit. U bë një rrëmujë,

që nuk e merrte vesh i pari të dytin. Njëpër rrugë vraponin demonstrues e karabinierë. Ngatroheshin njerëzit e nuk kuptohej kush kishte qenë në demonstratë e kush po kalonte rastësisht andej.

Disa nga pjesëmarrësit në demonstratë, duke kaluar nga sheshi i Bezistanit, njohën menjëherë Kozmanë, një djalë të shkathët, me fytyrë të hequr, po të ëmbël, me sy depërtues. Ai ndodhej në mes dy karabinierësh aty pranë shatërvanit të rrumbullaktë. Këta po përpiqeshin ta merrnin me vete. Kozmai i dha një të shtyrë aq të fortë njërit prej tyre, sa që ky u përplas me gjithë pushkë në murin e shatërvanit. Në atë çast dikush i thirri:

— Ikë, Kozma!

Karabinieri tjetër u hutua nga kjo e papritur. Kozmai ja dha vrapit, pasi e goditi edhe këtë me grusht në fytyrë. Kur erdhi në vete, karabinieri qëlloi me armë, po shoku ynë kishte marrë kthesën më të afërme pranë rrapit shekullor.

Të nesërmen, njerëzit e qytetit panë një grup të rinjsh që ecnin njëpër rrugët me kalldrëm, në mes të një roje të fortë karabinierësh. Ata po i çonin në burgun e vjetër. Të gjithë qenë kapur gjatë demonstratës. Ndonjëri nga ata kishte qenë edhe më parë në «shtëpinë e dytë», siç e quanin burgun fashist.

Si për çudi, midis tyre ishte edhe Kozmai. Si qe e mundur? Në burg, kur njëri nga shokët, që kishte parë skenën të shatërvanit, e pyeti se si e kapën, Kozmai tregoi:

— Shpëtova mirë nga ata dy zagarët, po nuk më eci më pas. Që ta merrni vesh, sapo u largova

nga sheshi, ngadalësova çapin dhe u përpoqa të rregullohem dosido e të dukem më i qetë. Po, siç u pa, nuk e bëra mirë këtë punë. Eca përmes portës së kalasë dhe, tek po merrja kthesën në rrugicën djathtas furrës, u dhanë përballë dy karabinierë e një xhandar. U stepa për një çast, po brenda dy tri sekondash vendosa të vazhdoja rrugën e të mbroheshja si të mundesha. Po të isha kthyer, do të kisha gabuar më rëndë, se në çast u duk një patrullë tjetër fashiste prapa krahëve të mia nja 15 çapa larg. Kur u ndodha përballë karabinierëve, xhandari seç u foli të dyve. Unë rrëshqita me shpejtësi dhe, megjithëse njëri nga karabinierët u kthye për të më kapur, e shtyra fort dhe ja mbatha. E keqja që se, pas tyre, në drejtimin tim, po vinte një tjetër patrullë, kështuqë nuk pata asnjë rrugëdalje. Në raste të tilla, njeriu përmbledh të gjitha forcat. Kështu bëra dhe unë. U përpoqa t'i ngjitesha murit aty pranë, u kapa me duar e me thonj, po pa sukses. Atëhere më hipi një inat kaq i madh, sa vendosa të bëj të pamundurën. U lëshova me vrull midis patrullës dhe për pak e çava «kordonin», po të mos më kish goditur njëri nga ata me kondakun e pushkës. Dhe ja, tani jam këtu bashkë me ju.

Për fat të mirë, ata dy maskarenjtë e parë, me të cilët ish përleshur Kozmai te shatërvani, nuk dihej se ku ishin me shërbim, kështuqë ajo ngjarje mbeti e pazbuluar për fashistët.

Të burgosurit për faje ordinere i shikonin të porsaardhurit me çudi, po dhe me një farë simpatie. Atyre u bënte përshtypje të madhe se si këta çunakë, shumë nga të cilët kishin ende push në faqe, nuk ankoheshin për asgjë; po më e madhja ishte

se nuk çanin kokën fare për administratën e burgut. I përbuznin hapur xhandarët dhe karabinierët, këndonin këngë të ndaluara, lexonin nga ato letrat që flitnin për luftën kundër fashistëve italianë. Dhe kjo nuk ishte e pakë.

Pas disa ditësh, këta të burgosur për faje të ndryshme u miqësuan me «demostruesit» (kështu filluan t'i quajnë) dhe kjo miqësi erdhi e u trash sa më shumë që depërtonte te ata qëllimi i luftës së rinisë e të popullit tonë. Arriti puna që demonstruesit të bëjnë për vete jo vetëm të burgosurit e tjerë, po dhe njërin nga xhandarët që kryente shërbimin aty. Ky xhandar, Hysen e quanin, një fshatar nga jugu, tërhoqi vëmendjen e grupit të ri, sepse, ndryshe nga të tjerët, kishte një sjellje tjetër. Shokët tanë e pikasën këtë gjë, e afruan dhe Hyseni u solli shërbime të mira. Arriti puna gjer aty sa, kur futnin në burg komunikata dhe materiale të tjera nga jashtë, ai, edhe pse e shihte këtë gjë, nuk e hapte gojën fare. Më vonë u muar vesh se një vëlla i tij kishte dalë në çetë.

Një mbrëmje ndodhi diçka e papritur. Njeri nga karabinierët italianë, që vinte herëpashere në burg, fytyra e të cilit sikur pasqyronte tërë ligësitë, aq i shëmtuar ishte, i diktoi Kozmait një letër të marrë nga jashtë. U lëshua si qen i tërbuar kundër tij duke bërtitur e sharë. Kozmai bëri sikur s'e dëgjo, shpejtoi hapin në drejtim të birucave të burgut dhe fshehu letrën në trupin e tij. Fashisti e arriti dhe e goditi me grusht. Si përgjigje, karabinieri mori kusurin. Sakaq u mblodhën të tjerë. Përnjëherë u duk në mes të njerëzve një njeri i shkurtër, po shpatullgjërë. Shokët njohën Demirin, të burgosurin për faje ordinere, që i donte mjaft, i cili, në një

kohë me shokët e tjerë, e për lau italianin. Veç ta shikoje se si e hoqi mënjanë, ca si me të mirë, po më shumë me të shtyrë, dhe e çoi drejt portës që ndante oborrin me koridorin e jashtën. të ndërtesës.

Të nesërmen u përhapën zëra për raprezalje, u fol për internime, për transferime në burgje të qyteteve të tjera. E për çfarë nuk u fol. Nga këto, u vërtetua vetëm njëra.

Pas ca ditësh, disa do t'i nisnin për në burgun e vjetër të Tiranës. Fashistët italianë kujtonin se kështu do të thyenin vendosmërinë e të rinjve tanë, të popullit tonë. Po u gabuan përsëri. Edhe në burg ata nuk ishin zotër të vërtetë. Forca e tyre përmbidhej vetëm në atë murin e zyrtë e të lartë të burgut, që i mbante të rinjtë larg shokëve, po, si të thuash, vetëm formalisht. Edhe aty brenda ndihej epërsia e shokëve tanë të burgosurve. Nuk ishte epërsi që mbështetej në numrin e armëve e as në ligjin e atij që ka pushtetin. Jo. Epërsia e të burgosurve mbështetej në idetë e mëdha, në atë flakë të pushuar që digjte përbrenda çdo kraharori e që, si një llavë e zjarrtë, merrte përpara çdo gjë të keqe. Armiqtë përpiqeshin më kot t'i shikonin si kalamaj të gënjer, të rrëmbyer, që vritnin veten me duart e tyre, në vend që të shijonin «të mirat» e botës së tyre, kurse grupi i të rinjve qeshte e tallej me varfërinë e tyre mendore dhe i urrente edhe më tepër.

Ditën kur do t'i nisnin për në burgun e vjetër të Tiranës, fashistët ishin pispillosur e rregulluar mirë e bukur. Do të shkonin në kryeqytet, s'ke ç'i thua. Kishin edhe ata planet e tyre, botën e tyre aq të vogël e meskine, sa që të vinte për të qeshur tek i dëgjoje të flitnin për kafenetë luksoze dhe qejfet

e çthurura të kryeqytetit. Nja dy prej tyre u futën në oborr të burgut dhe vështruan një copë herë. Siç dukej deshën të matnin, në një çast kritik, botën e tyre të zbrazët me atë të të rinjve tanë plot me ideale të larta. E bënë këtë, po, siç u pa, u penduan shumë shpejt, kur vunë re qendrimin aq mospërfillës të atyre të rinjve, të cilët me këngë revolucionare e me fjalë të ashpra, ua përplasën në fytyrën trillin e tyre.

Më e madhja ndodhi më pas. Përpara burgut, në rrugë, erdhi një maqinë. Shoferi frenoi dhe i shoi motorin. Pas pak u hap porta e hekurt dhe në oborin e burgut u futën dy karabinierë dhe një oficer fashist. Ky i fundit nxori nga çanta e bukur një listë emërore dhe përmendi ata që do të nise-shin. Pastaj iku shpejt e shpejt. Dukej qartë se u frikësua nga vështrimet plot urrejtje të të burgosurve. Pas ndonja një orë, ata që do të iknin, i nxuarën jashtë. Të tjerët, që mbetën aty, u përshëndetën me shokët e tyre dhe u uruan me gjithë zemër të vazhdonin luftën kundër pushtonjësve e tradhtarëve.

Në dritaret e atyre pak shtëpive përreth u dukën fytyra njerëzish. Ata shikonin plot kureshtje. Në rrugë filluan të grumbullohen mjaft të rinj e shokë lufte, prind e të afërm të të burgosurve. Pas një heshtje të rreme, u dëgjue një zë gruaje:

— Të keqen nëna, bëhu burrë, se këta të mallkuar do ta pësojnë si mos më keq!

Nisi një rrëmujë e vërtetë. Njerzit thërrisnin e hidhnin parulla, ndërsa karabinierët shpejtonin, i shtynin të rinjtë e burgosur drejt maqinës. Në të hipën më shumë fashistë, se sa të burgosur. Njëri nga të rinjtë, duke përshëndetur me dorë,

ja nisi «Internacionales.» Një nga rojet e përplasi me forcë në maqinë. Pas kësaj u dëgjuan zëra të tjerë që këndonin. Maqina u nis, po gumëzhima e motorit nuk e mbyti dot këngën revolucionare të të rinjve, e cila shkrihej me të thirrurat e zemëruara të njerëzve.

Ishte një skenë e thjeshtë me përmbajtje të madhe. Ata që i mbronte ligji, kishin frikë nga njerëzit e thjeshtë të popullit, nga kënga e tyre. Idetë e të rinjve nuk mund të lidheshin me pranga dhe të mbylleshin në burg.

FJALA E SË VËRTETËS

Në ditët e shënuara, shpesh ringjallen kujtimet dhe sikush, sipas mënyrës së tij, mendon për atë që i ka ndodhur dikur, bën krahasime dhe kapet nga ndjenja të ndryshme.

Në këto radhë do të tregoj për një ngjarje shumë të vogël në vetvete, po që fundja diç vlen të paktën sa herë që vjen 25 gushti, dita e shtypit tonë popullor.

... Viti 1942. Atë ditë gushti mëngjezi erdhi si zakonisht me hallet dhe kokëçarjet të cilat na kishte shkaktuar pushtimi i huaj. Jeta dukej sikur rridhte e qetë, po në të vërtetë ishte e vrazhdë e plot tallaze.

Në një rrugicë shumë të ngushtë të qytetit të vjetër të Elbasanit takova shokun tim, Ptolemeun. Këmbyem ca fjalë mbi punën që do të bënim dhe u ndamë. Kur filloi të errej, u takuam përsëri pranë plepave, në të dalë të qytetit.

— E, Ptoleme, a e more gjithë materialin, — e pyeta. Ai më tha se çdo gjë ishte në rregull. Pastaj, si këmbyem ca fjalë të tjera, muarëm rrugën për në fshat.

Si për inatin tonë, qielli u mbush dalngadalë

me re të zeza dhe filloi të ndriçonte nga shkrepëtimat. Nuk shkoi shumë dhe nisi të bjerë një shi i rrëmbyer.

Të lagur gjer në palcë, ecnim në përruan plot me ujë, duke menduar për komunikatat dhe për thirrjen e partisë, që fliste edhe për fshatin. Këto letra duhej t'i ngjithnim nëpër pemët ose nëpër murret e shtëpive të fshatarëve. Në ato çaste na kishin pushtuar ato ndjenja dhe mendime që kemi zakonisht, kur e përqendrojmë vëmendjen te një qëllim. Herë pas here vështrimet tona takoheshin dhe ne buzëqeshnim.

Kaloi kështu afro një orë. Shtëpitë e shpërndara të fshatit bënë ballë. Një qen, me zërin e tij të trashë, ja nisi të lehurit, sikur të kish rënë ujku në vathë. Ne ecnim pa pushuar, gjersa ju afruam fshatit. Ndaluam pranë një gorice të vjetër, muarëm frymë thellë, u shkundëm dhe mbajtëm vesh. Asgjë s'pripëtinte. Edhe qeni pushoi të lehuri.

— Sa s'më pëlqen kjo qetësi, — tha Ptolemeu dhe deshi të vazhdonte, po, ngaqë i merrej ca goja, s'e nxori pastaj dot lidhësen «po».

— Qite të shkretën, — ja prita unë, — apo të ka hyrë të ftohtit në palcë?

— Jo, mor, jo, po mendja më rreh te këto që kemi me vete; duhet të kemi mendjen, se ata pizevengë sillen shpesh këndej.

— Mirë, mirë, — ja ktheva unë, — po duhet filluar shpejt, se sikur jemi vonuar ca.

Këto qenë fjalët e fundit që këmbuem. Pasi lamë pikëpjekjen po te ajo goricë dhe si ngjitem thirrjen e partisë dhe një komunikatë në trungun e saj të vjetër, punë që mund të kushtonte shtrenjtë,

po ta kishin pikasur armiqtë para se të ktheheshim, u futëm nëpër rrugët e fshatit, sikush më vete.

Shiu nuk pushonte, po nuk e çanim kokën. Ne duhej të kryenim detyrën që na ish ngarkuar, prandaj me shpejtësi të madhe i ngjitëm ato letra. E dinim se çonim fjalën e partisë në masat e kjo na ngrohte zemrat e na bënte ta kryenim këtë punë shumë të vogël me entuziazëm të madh.

Çdo gjë kaloi mirë e bukur dhe ne ishim përqendruar aq shumë në punën tonë, sa nuk vumë re fare këpucët prej sholle, që na ishin bërë si lëpitka nga uji i përroit e i shiut dhe që të nesërmen na u desh t'i flaknim tej.

Si mbaruam punë, u takuam më parë se të arrinim te gorica, afro pesëdhjetë metra pranë saj. Aty vendi ishte plot me drurë e me driza dhe këto s'na linin të shikonim më tutje. Pasi i treguam njëri tjetri ç'bëmë, muarëm udhën e kthimit. Me të dalë te një si shesh i vogël, shtangëm në vend: te gorica po qendronte në këmbë një njeri. Shqetësimi nuk zgjati shumë, sepse pamë një fshatar plak, që mbante një shkop në dorë dhe seç lëvizte me dorën tjetër në pemë.

— Hajde të bisedojmë me të, — tha Ptolemeu.
— Një rrugë e dy punë.

Unë nuk ja pëlqeva mendimin, po ai nguli këmbë dhe ashtu bë më. Ju afruam fshatarit, i cili, kur na pa, lëvizi me një farë ndrojtje, po përnjëherësh u qetësua. Siç kuptuam pak më vonë, ky plak e kishte marrë me mend se ajo letër që puna jonë.

— E xhaxho, ç'po lexon ashtu? — e pyeti Ptolemeu.

— Asgjë, more djem, ku di unë të lexoj; po

të ishte djali im, ndryshe, po unë s'kam haber fare nga shkrimi . . . — Dhe, pa na lënë të flitnim, vazhdoi:

— Me ç'më duket, janë nga ato të partisë, po hapni sytë, djem, se ata lanetrit janë tërbuar; andej nga qyteti u zbardhën rrugët. Pa më thoni, ç'është kjo, se, besa, ju flisni aq, s'dini as hile, as dredha. Kur kam qenë edhe unë si ju, haja hekurin me dhëmbë, po dhe ju, ama, tërt s'jua bën syri, të fortë jeni, hë de hë, pa ma lexoni ! . .

Ptolemeu më shikoi i kënaqur, qeshi dhe filloi t'ja lexonte. Plaku tundte kokën dhe herë-herë duke sikur mendonte, po kur dëgjoi vuajtjet e fshatarëve dhe kur mori vesh se cila ishte rruga për të shpëtuar, u prek aq tepër, sa nisi të na qante vetë hallet. Nxori kutinë e duhanit dhe na dha të dridhnim nga një, po në çast u dëgjuan të lehurat e qenve dhe një pushkë u zbraz ndanë fshatit. Plaku u shqetësua dhe na tha të largoheshim. Ne bëmë nja dhjetë çapa dhe instinktivisht kthyem kryet pas dhe pamë se si e hoqi thirrjen e komunikatën nga pema, i palosi dhe i futi në gji. Në ato çaste gëzimi, mendonim se si këta njerëz të thjeshtë të fshatit po e kuptonin çdo ditë e më shumë fjalën e partisë, fjalën e së vërtetës . . .

Po, njerëzve të fshatit do t'u kujtohet gjithnjë se me sa kujdes dhe dashuri punoi partia për të çuar edhe në kasollet më të largëta dritën e shpëtimit nga varfëria, shtypja e padituria. Edhe sot e kësaj dite ata kujtojnë sa e sa bij e bija të popullit tonë që lanë me gjakun e tyre këtë tokë të shtrenjtë për të përhapur fjalën e partisë.

«DAMARËT» U PRENË

24 korrik 1942. Nëpër rrugët me kalldrëm të Elbasanit filluan të lëviznin banorët e parë. Ca nga ca qyteti u gjallërua. Erdhën orët e mesditës së nxehtë, që të plogështojnë. Asgjë e re: monotonia e ditëve të qeta, vështrimet plot dyshim të spiunëve, shakatë pa kripë të ushtarëve të dehur fashistë...

Ja dhe mbrëmja pa erë, mbrëmja plot zagushi. Nëpër rrugët asnjë nuk shpejton; ka nga ata që flasin me zë të lartë, ca të tjerë shikojnë reklamat e një filmi. Çdo gjë të jep përshtypjen se së shpejti nata e heshtur do t'i mbledhë të gjithë në shtëpitë, do të ndizen dritat e zbeta dhe shumëkush do të ulet pranë radios për të mësuar të rejat e frontit...

Po atë mbrëmje, dy të rinj kaluan urën e Zaranikës. Ptolemeu, me trup të hedhur, fytyrë të hequr, veshur pastër, njërën dorë e mbante gjithnjë në xhepin e xhaketës, tjetri, pak më i shkurtër, ecte më me kujdes, sepse një sy i stërvitur mirë i ndonjë njeriu të keq mund të dyshonte për diçka që fshihej nën xhaketën e tij ngjyrë kafe.

Të dy shokët ecnin në mugëtirën që po binte buzë ullishtes, në drejtim të perëndimit. Asgjë nuk

tërhoqi vëmendjen e udhëtarëve. Pas pak u futën nën ullinj të e moçëm, më të djathtë të xhadesë. Befas diçka këceu nga një ferrë dhe kaloi përpara tyre me shpejtësi. Të dy qëndruan në vend, duart lëvizën nën xhaketat e sakaq qeshën.

— Pisk e kemi, Ptoleme, shenjë e keqe ky lepuri që na preu udhën, — i tha shoku me shaka.

— Po, po, siç duket do të shkojë të lajmërojë për ne, — ju përgjegj tjetri. Qeshën përsëri, vështruan nga të gjitha anët dhe u ulën rrëzë një trangu të prerë sa për të pushuar një minutë.

Në rrugë kaloi një maqinë me ushtarë fashistë. Ca fshatarë me kafshë ktheheshin nga qyteti. Asgjë shqetësonjëse.

— Fillojmë, se u vonuam, — foli Ptolemeu. Menjëherë hynë në veprim armët e përshtatshme për atë natë, sharra e vogël, dara dhe duart.

Në largësi të shkurta nxinin drurët e linjës telefonike-telegrafike. Xhadeja nuk ishte larg, duhej punuar me kujdes.

— U ngjita, Ptoleme, ti këput telin që do të bjerë poshtë dhe hidhe tutje, — i tha shoku dhe si mace e shkathët e kapi shtyllën me të dyja duart e sa çel e mbyll sytë u gjend në majë. Dara kërciti, teli u këput. Zbriti poshtë dhe ju ngjit shtyllës tjetër; e kështu vazhdoi me shumë shtylla. Futën në punë edhe sharrën.

Në fytyrat e të dy shokëve dallohej kënaqësia, që ndjejmë zakonisht kur kryejmë detyrën.

— Me këtë të kërcitur, nuk është çudi të na ketë dëgjuar njeri në rrugë, — tha Ptolemeu, kur u rrëzua një shtyllë.

Vunë veshin, po nuk dëgjuan asgjë të dyshimtë. Muarën udhën e kthimit shumë të emocionuar.

Kur ishin rralluar lëvizjet në qytet, të dy sho-
kët kalonin Zaranikën dhe dredhonin nëpër rrugicat
e ngushta e në shpirt ndjenin gëzim. Pas pak, dy
porta hapeshin dhe dy të rinj hynin me pamjen e
zakonshme të njerëzve të qetë.

Partia kishte urdhëruar që nata e 24 korrikut
duhej të ishte një natë sulmi të përgjithshëm mbi
armikun, të pritëshin telat, shtyllat telefonike e tele-
grafike në të gjitha qarqet...

Të gjitha njësitet e qytetit e çuan në vend këtë
urdhër të partisë. «Damarët» e fashizmit u prenë në
të gjithë Shqipërinë.

Të nesërmen, në kampin armik pati alarm. Fa-
shistët i kapi frika, njerëzit e thjeshtë të popullit
u gëzuan, besimi u shtua, dashuria për partinë u rrit.

Kjo ngjarje qarkulloi gojë më gojë dhe kushdo
e vlerësonte si shprehje e fuqisë së popullit krye-
ngritës.

MISIONI

Duke shkruar këto radhë, m'u kujtua diçka, që e kam lexuar këtu e shumë vjet të shkuara.

Në një vend të botës së vjetër kapitaliste, në dhomën e një njeriu të lodhur nga pesha e rëndë e jetës, hyri një mik i tij. I zoti i shtëpisë kishte ngulur vështrimin në një pikë të murit përballë. Miku e pyeti:

— Ç'plane je duke thurur, miku im?

— Unë shoh vetëm fatkeqësitë e së kaluarës sime, vuaj për të tanishmen, tmerohem për të nesërmen.

Këtij njeriu ja kishin grabitur mundin dhe djer-sën, gëzimin dhe qetësinë shpirtërore. Kështu ndodh atje, jo me një, po me të gjithë njerëzit e thjeshtë të punës. E kaluara nuk u ndez asnjë shkëndijë shprese për të ardhmen. Ata nuk kanë ç'të kujtojnë dhe nga se të frymëzohen. Te ne ngjet e kundërta. Ne kemi ç'të kujtojmë. Ne e vështrojmë të kaluarën tonë me krenari dhe të ardhmen me besim. Ne nuk harrojmë sakrificat, vështirësitë që kemi lënë prapa; se kështu e kemi më lehtë të kuptojmë atë që duhet të bëjmë.

Në këtë shkrim do të flas shkurt për një ngjarje

shumë të rëndësishme, sepse një përshkrim i përsosur është bërë në librin me titull «Kujtime nga jeta e Brigadës së Parë Sulmuese».

24 vjet më parë, disa qindra partizanë shkruan një faqe të shkëlqyeshme në historinë e luftës sonë çlirimtare. Në dimrin e fortë të vitit 1944, afër tri batalione të kësaj brigade muarën rrugën përtej Shkumbinit, për në Shqipërinë e mesme.

Marshime të tilla të vështira në luftë për liri kanë bërë sa e sa herë partizanët. Vetëm kësaj here kjo rrugë kishte diçka të veçantë, madhështore, të bukur dhe të ashpër, që i ngrohte zemrat edhe në mes të acarit të dimrit. Kjo diçka e veçantë ishte çasti që jetohej, një çast që nuk mund të harrohet kurrë, sepse kishte të bënte me një provë të madhe të atyre njerëzve të thjeshtë, bij të partisë dhe të popullit.

Prova e vështirë filloi sapo u kalua Shkumbini i rrëmbyer e dënga me ujë të shkumëzuar diku afër Përrenjasit. Përpara ishte një vend i pashkelur dhe dukej sikur edhe moti, me dimrin e egër, ishte kundër partizanëve. Gjermanët dhe reaksioni, të armatosur gjer në dhëmbë, nuk vonuan t'i godasin këta «kokëkrisur», që guxuan të shkelin në strofën e tyre pa i përfillur. Po, a donin t'ja dinin partizanët? A kishte nder më të madh për ta se sa kryerja e një misioni të vështirë që u ishte besuar? Ata e kuptonin se u ishte ngarkuar një detyrë e rëndësishme politike dhe ushtarake.

Ja tek u mblodhën në një çukë të zveshur të fshatit Skroskë. Krisën pushkët dhe paralajmëruan se rruga do të ish plot sakrifica. Po, tamam aty, partizanët ju përgjigjën fjalëve të komandantit të tyre me vendosmërinë e patundur për të çarë vetëm

përpara, drejt qëllimit të caktuar. Ata bënin vetëm një pyetje: a do ta përmbushnin detyrën në kohën e duhur? Ishte e vetmja gjë që i mundonte. Dhe në dëshirën e tyre për të përligjur besimin që u kishin dhënë, shihej ajo forcë e madhe shpirtërore, që u jepte guximin dhe trimërinë e heronjve. Dhe, kur mendon se kjo vendosmëri përzihej me krismat e pushkëve e të mitralozëve, atëhere kupton sa prekës, sa ngjethës ishte ai çast që e ngriti edhe më lart lavdinë e Brigadës I Sulmuese.

Ditë e natë eci kolona partizane, çau dëborën dy metra të trashë, luftoi me vetmohim. Sa të papritura kishte ky marshim i madh! Nuk e kemi fjalën për luftimet natë e ditë, për të pangrënët. pagjumësinë, çarjen e dëborës rreth dy metra, ecjen për dhjetra orë pa pushuar. Jo. Të gjitha këto ishin tanimë bashkudhëtarë të partizanëve. Këta ishin mësuar me kësisoj vështirësish. Po që të ndodheshin në pozita në tilla, që të binin në rrethime të dyfishta, e që nganjëherë t'ja linin armikut rolin e befasisë, këtë shumë pak midis tyre e mendonin.

Dëshmitarët e këtij marshimi nuk do të harrojnë për tërë jetën çastet aq të vështira, po aq të lavdishme, të mbushura me heroizmin masiv, që kaluan ato ditë.

Ecte kolona partizane, luftonte pa pushim dhe skuqte dëborën e trashë me gjakun e saj. Ky nuk ishte vetëm gjak i derdhur nga ata që binin gjatë përpjekjeve me armikun, po edhe gjak që kullonte nga këmbët e zbathura e të enjtura të atyre dhjetra partizanëve, që, megjithatë, ecnin krah për krah me të tjerët, duke u mbajtur e rrëshqitur mbi dëborë, të mbështetur ose të ulur në ca copa dërrase ose

druri, të cilat i quanin me shaka «slitat tona partizane». As armiku, as dëbora, as uria, asgjë nuk e mposhte dot shpirtin e lartë luftarak të kolonës partizane. Nuk pati ankime, çdo dhëmbje, çdo humbje e shokut kthehej në etje për hakmarrje dhe në vendosmëri për të kryer detyrën.

Oh, ç'gëzim, ç'dëshirë për të pushuar qoftë edhe pak minuta në ato kasollet e vjetra të Dragoshtunit! Le pastaj kur vunë në gojë edhe mish.

Është natë, një natë e errët sterrë. Përqark nuk dallohet veçse bora e bardhë. Një pjesë e partizanëve ecën pa zhurmë. Kur ndonjërin e kap kolla, fut shaminë në gojë. Kur ja, përpara shquhet diçka e zezë. Anash ndodhet një gardh. Gjënden tri dhjetë deri dyzet metra afër. Papritur zbrazen shume pushkë përnjëherë. Plumbat vërsëlleshin fare pranë partizanëve. Pa humbur kohë, ata përhapen në formacion luftimi dhe «sharrëshi» i tyre jep kushtimin e sulmit. Pas pak mercenarët ua mbathin.

Ecën kolona partizane, lufton dhe nuk çlodhet e aty nga mesdita e 29 shkurtit futet në fshatin Qarishtë. Reaksionarëve të fshatit nuk ua mbajti t'i pritnin me pushkë, megjithëse nga dritaret, që ngjanin me frengjitë, armët e tyre «përgjonin» të gatshme. Nuk u shkoi as dredhia që deshën të përdornin duke propozuar të çlodheshin ca, të hanin pak bukë, me qëllim që të vonoheshin dhe pastaj të binin në kurth. Komandanti, me imprehtësinë e madhe të një udhëheqësi të shquar politik dhe ushtarak, e pati të qartë situatën aq mirë, dhe jo vetëm aty, në Qarishtë, sa që çdo e papritur u kapërcye me sukses.

E lanë Qarishtën për të kaluar nëpër të vetmin shteg të malit të Letnit. Në këtë shteg edhe dhitë

me vështirësi mund të kalonin. Rrugë tjetër nuk kishte. Armiqtë i ndiqnin nga prapa. Praparoja u godit tradhëtishtë në Qarishtë. Kur ja, sapo ju afruan qafës, prapë pengesë. Nga maja e Letmit kërciti pushka. Gjermanët ishin futur në Qarishtë dhe qëllonin nga pas me mitraloz të rëndë. Partizanët u ndodhën në një situatë shumë të vështirë. Po, kur komandanti, që ishte bashkë me pararojën, tha ato fjalë që tingëlluan aq të qarta, aq të freskëta, aq të fuqishme, s'kishte forcë që t'i ndalonte partizanët.

— Përpara shokë! Në sulm, përpara, Brigadë e parë, për lirinë e popullit, për partinë, për atdheun, për Stalinin, përpara! — tingëlloi zëri i tij i fuqishëm.

E ç'të shihje atëhere. Në mes të krismave të pushkëve e të mitralozëve, çdo zemër partizane u drodh dhe u çelnikos më shumë. Përmes dëborës, përmes plumbave të mercenarëve u flakën bombat partizane, kërcitën mitralozët tanë dhe armiku u çakërdis, e la shtegun bashkë me të vrrarët. Gjermanët nuk ja dualën ta mbyllnin rrethimin për të prerë rrugën e qafës së Letmit. Kolona partizane vazhdoi të ecë me shpejtësi përmes dëborës dhe breshërit të fortë, që binte pa pushim. Ecte kolona ditë e natë. Gjumi kërkonte t'i mposhte njerzit tanë, po këta futnin kokën në dëborë dhe sytë sikur sikur u lehtësoheshin. Përsëri luftë në fshatin Valë. Njëzet e katër armiq u vranë. Vetëm një nga partizanët. Gjermanët nga nuk janë nisur për të na asgjësuar. Po batalionet tona manovrojnë me aq shkathësi, sa armiqtë çuditen.

Ja, kolona futet në Shëngjergj dhe kjo i çudit e i tmerron edhe më tepër gjermanët dhe reaksionarët, kur mendojnë se këto forca ju afruan aq afër Tiranës.

Në këtë marshim, partizanët e ndjenë më të fuqishme se çdo herë tjetër atë forcë të madhe që kishte farkëtuar te ata ideali i përbashkët, shoqëria e re ushtarake. Shoku e rrëmbente shokun e plagosur në mes të plumbave, pa u merakosur për jetën e vet. Ata ndanin me njëri tjetrin gjithshka: vuajtjet, urinë, hidhërimet dhe gëzimet e fshehura në ndonjë letër të zhubrosur, që ruhej në xhepin e vogël të xhakëtës e ku lexoheshin fjalët e ëmbla të njeriut të dashur. Kjo shoqëri e fortë partizane, e çimentuar në provën e rëndë të luftës, e ngriti më lart qëllimin e tyre të madh.

Ja dhe rruga e kthimit, pas kryerjes së misionit. Kërrabë. E kapërcyen edhe vendin e rrezikshëm pa ndonjë të papritur dhe arritën në Pezën tonë, në Pezën partizane. Sa të gëzuar e ndjenë veten kur muarën pak frymë e u çlodhën, duke shijuar pilafin e ngrohtë, që u vunë shokët tanë të luftës.

E lanë Pezën heroike para se gjermanët t'i sulmonin dhe ja, këto batalione të Brigadës. I çarmatosën në fshatin Rasë të Dumresë 170 mercenarë. Kjo ra si një dush i ftohtë në kokë të armiqve.

Ecnin partizanët dhe këndonin:

*Në çdo vend ku do shkel Brigada e parë,
s'ka armik që ta ndalë në rrugë të saj*

.

LAPIDARI BUZE LIQENIT

Sa herë marr rrugën e Korçës dhe maqina lë pas Qafën e Thanës, sjell në mendje një pikë të bregut të liqenit kaltërosh. Dhe ja, pas një copë rruge, para meje del ai rrip i ngushtë fushe, rrethuar me kodra, ku spikat një lapidar i bardhë. Më njëherë më pushton mallëngjimi; jo, disa ndjenja bashkë... Me siguri disa ndjenja sepse, sapo largohet nga sytë e mi ai horizonti i ngushtë, e kthej disa herë kokën prapa e shikoj atë vend ku ka mbetur diçka nga koha e rinisë sime, ku miqësia partizane njohu humbjen e rëndë të shokut, të komandantit, të birit të partisë. Nuk di përse ja filloj mbyturazi këngës që na mallëngjente aq shumë atëhere:

*Një tym, një mjegull duket,
ca krisma ndihen larg,
Një tufë trimash sulen,
me shpirt e zemër flakë.*

Nuk po përshkruaj luftën e Pojskës, ku ra Heroi i Popullit Reshit Çollaku, po do të tregoj për

Reshitin si njeri, si shok lufte, si komandant. . .

E njoha gjatë pranverës dhe verës së vitit 1943. Atë ditë ai nuk ishte në Pleshisht (baza e partizanëve). Kur u kthye, u ndodha bashkë me Koli Gushon dhe pashë një grumbull partizanësh që bisedonin. Përnjëherë dallova diçka që më tërhoqi vëmendjen, dhe i them shokut:

— A dëshiron të të them cili është Reshiti?

Koli më vështroi dhe tundi kokën në shenjë pohimi:

— Ja, ai atje, që flet duke lëvizur këmbë e duar.

— Si e dallove?

— Me ndihmën e «psikologjisë», — i thashë. Shoku qeshi me zemër dhe unë ja shkoqita më mirë «pse-në».

Me të vërtetë Reshiti binte në sy për shkathësinë, thjeshtësinë dhe zgjuarësinë e tij. Këto tipare spikatnin në çdo çast dhe, bashkë me bukurinë shpirtërore, e bënë të afërt për të tjerët që në njohjen e parë. Kështu ndodhte me të gjithë. Partizanët e donin shumë komandantin e tyre, sepse, para së gjithash, ai ishte shok, mik, njeri. . .

Një ditë rastisi të shkoja me të në një fshat të Mokrës. Rrugës takuam një fshatar të armatosur, që desh të kalojë pa qendruar, pasi na hodhi një vështrim me bishtin e syrit. Reshiti e ndali dhe në mënyrë të njerëzishme e futi në një bisedë të gjerë dhe të gjatë. Siç m'u duk, e bëri të lëkundet në pikëpamjet e tij, sepse, kur u largua, e pashë që fshatari tundi kokën duke psherëtitur. Kjo ndodhi atëhere kur Balli Kombëtar nuk ishte demaskuar ende sa duhej. Si u larguam ca, Reshiti më tha:

— Nuk është i keq, po ka ca miq ballistë që e pengojnë të marrë rrugën e drejtë. Me këtë duhet

punuar shumë, që ta shkëpusim nga kthetrat e reaksionit.

Njëherë tjetër Reshiti bisedonte me një partizan, që nuk e kish kryer si duhej detyrën. Të them të drejtën, në fillim u gabova dhe gjykova keq, po në fund u binda plotësisht se sa mirë, sa drejtë veproi komandanti. Fjalët që i tha goditnin fort, lirin vrugë të thellë në ndërgjegje, pa prekur dinjitetin, pa fyer.

Në krahinën e Mokrës, dhe jo vetëm atje, të gjithë e njihnin si një nga organizatorët më të vendosur, më të zjarrtë të luftës kundër fashizmit, që çdo gjë ja kushtonte çështjes së drejtë të popullit dhe të partisë.

Partia e ngriti lart Reshitin, e kaliti me vetitë e bukura të komunistit.

Duke shkruar këto radhë mendova të mos përmend luftën e Pojskës, po ja që më del përpara ajo ditë ugurzezë e 16 korrikut 1943. Nuk kam të drejtë të hesht, sepse më duket sikur shoh Reshitin të gjallë, si atë ditë, të shkathët, me maliherin në krah, që i vetëtinte, me sytë shkëndijë, që depërtonin thellë në çdo zemër patrioti.

Nuk do ta harroj kurrë atë çast, kur u varëm. tatëpjetë bregut të thepisur e u ndamë në drejtime të ndryshme. Aty e pashë për herë të fundit, të qeshur, të vendosur, plot besim se do ta shpartallosnim armikun. Pas ca orësh mësova lajmin e lidhur. Luftimet nuk kishin mbaruar. Motoskafi qëllonte me top nga liqeni, aeroplani fashist mitralonte 50 metra sipër kokave të partizanëve. Sa vështirë! Sa dhëmbje! Ishim ulur pranë një gëmushe të vogël, sa për të marrë frymë nga ngjitja e lodhshme, kur na thanë se Reshiti u vra. Nuk mbaj mend cili ishte

ai shok, që i shpëtoi pushka nga dora, cili ishte ai, që uli kokën për të fshehur lotët, po më kujtohet mirë se m'u bë një lëmsh në grykë. Humbje e rëndë për të gjithë, po asnjë nuk u ligështua. Vetë Reshiti e zinte në gojë shpesh forcën e partisë, fuqinë e kolektivit. Po në kësi rastesh është e pamundur të mos ndodhë diçka e veçantë te njerëzit. E pra, një pjesë e zemrave tona, që e ruante të gjallë Reshitin, u shkëput dhe vajti te ai, e tani qendron aty, buzë liqenit, te lapidari.

BUKA E LYER ME GJAK

Dikur, ka shumë kohë, kam lexuar një roman, në të cilin më bëri përshtypje një ngjarje, që zinte një vend shumë të vogël në libër. Dy ushtarakë luftonin në një llogore. Për të shpëtuar nga vdekja, njëri i përgatiti vdekjen tjetrit. Kushdo që lexon ose dëgjon diçka të tillë ndjen neveri dhe urrejtje. Po, kur mendon se sa e gënjeshtër është shoqëria në ushtritë kapitaliste, atëhere thua se këtu s'ka gjë për t'u çuditur. Kur vjen puna për të shpëtuar lëkurën, ushtarin fashist nuk e pengon asgjë për të kryer edhe aktin më të ulët, sepse edhe ligjet e rendit shoqëror kapitalist janë të tilla, edhe morali njerëzor ka arritur një pikë, kur njeriu bëhet ujë për njerinë.

Duke shkruar këto radhë, unë mendoj se sa i lartë, sa madhështor, sa njerëzor është akti, për të cilin do të tregoj. Kujtimet mbi këtë ngjarje nuk janë të rralla e as pjellë e një çasti, që, si të thuash, ish mbarsur me një vepër të tillë; jo, ajo që do të tregoj i ka rrënjët thellë në shoqërinë e re partizane, që brumosi në ato kohra qëllimi i madh i njerëzve të rinj, të cilët formonin ushtrinë tonë të çlirimit.

...1944, dimër. Bën ftohtë, bie dëborë. Kolona partizane kalon çaste shumë të vështira; 500 luftëtarë gjarpërojnë nëpër kreshtat e maleve të thepisura, nëpër gryka e qafa gati të pakapërcyeshme. Njerëzit ecin e ecin pa pushim. Vjen mëngjezi, thyhet dita, erret nata, mbulon gjithësinë e prapë vjen mëngjezi, po vargu partizan ecën dhe lufton. Fytyra të lodhura, sy të futur thellë, dhjetra partizanë që rrëshqasin me këmbë të zbathura; pamje rrëqethëse. Ata që nuk kanë qenë partizanë, po t'i shikonin kështu, nuk është çudi që të gjykonin keq, po ata që kanë kaluar nëpër vështirësitë e luftës, e dinë mirë se në ato sy të lodhur, në ato fytyra të vrara fshihej një forcë e madhe, forca e jetës, e fitores, shkëlqimi i dritës së nesërme që mbushte me vullnet, besim dhe guxim.

Natë. Ne ecnim nëpër dëborën e trashë dhe të butë. Para meje hidhte hapat çalë-çalë Eshrefi, një partizan 18 vjeçar. Ecte në heshtje, dukej shumë i lodhur. Prapa linte aty këtu një vrugë të hollë, të kuqe në dëborën e butë. E vështroja me dhëmbje këtë shok lufte, që e mundonte një kollë e thatë dhe e vazhdueshme. Ne ecnim dhe përpara na priste armiku, prapa na ndiqte po ai, natyra kundër nesh. Na dukej sikur çdo gjë na luftonte: edhe pesha e rëndë e rrobave të lagura, edhe këpucët e rënduara. Vetëm një gjë e kishim të lehtë si pendë: shpirtin.

Rreth e rrotull heshtje; ndofta në atë heshtje të gjitha mendimet e partizanëve treteshin larg në ditët e bukura që do të vinin. Edhe unë mendoja për këtë. Papritur u zgjova nga vegimet e këndshme, se pas meje u përplas diçka. Ktheva kokën dhe pashë Metin e vogël që ish shtrirë gati pa ndjenja.

— Çohu Met, ç'ke? — i them dhe vrapoj pranë tij.

— Nuk mundem, dua... — Fjala ju këput në mes, mbështolli buzët mavi, rrotulloi sytë dhe vari kokën. U tremba, po shpejt e mora me mend se ishte vetëm dobësi e shkaktuar nga të pangrënët. Me çfarë mund ta ndihmonim? Nuk kishim asgjë. Ndërsa qendroja i hutuar, pa ditur ç'të bëj, u afrua një shok tjetër dhe i fërkoj fytyrën dhe ja njomi buzët me dëborë.

— Duhet të ecim, — tha ai, — se shokët po largohen.

Ishim në faqe të një mali, ku, përveç dëborës dhe suferinës, nuk dëgjohej e nuk shihej gjë tjetër. Pastaj erdhi me çap të ngadaltë Eshrefi.

— Çfarë ka? — pyeti me një zë të ngjirur.

— Nuk duron dot të pangrënët, — i përgjigjem, sikur të isha mjek.

— Kam unë një copë bukë që më ka mbetur në çantë; është ca e fortë, po, nga e keqja, mund të hahet.

Tha këto dhe sytë i shkëlqyen, ngaqë i erdhi në ndihmë shokut në një çast të vështirë. E vura re atë copë bukë dhe se ç'më shtrëngoi në fyt. Mendo-va se sa e bukur, sa e madhe ishte zemra e partizanit, ç'virtyte, ç'cilësi të larta kish formuar shoqëria partizane te njerëzit, sa shumë i kish kalitur lufta bijtë e popullit tonë. Kthej sytë nga Meti. Ai rrinte i shtrirë, i verdhë në fytyrë, po sytë i kish të hapur dhe, siç duket, e kish dëgjuar bisedën tonë. Eshrefi nxori nga çanta copën e bukës dhe, në kohën kur po më shtrinte dorën për të ma dhënë, e kapi një kollë e fortë, u lëkund dhe ndërsa unë mora bukën, ai u ul mbi dëborë.

Shoku që kisha pranë i vajti në ndihmë. Unë i zgjata copën e bukës Metit dhe sakaq vura re se ajo ish spërkatur me gjak. Ai nuk pranoi ta merrte dhe, për të zhdukur çdo dyshim, më tha:

— Shiko, mos mendo keq për mua, unë s'e dua atë copë bukë se Eshrefi është i sëmurë, po...

— Hajde more, mos na thuaj dokrra tani. Merrre dhe haje, se do të mbetesh këtu, — i them.

— Nuk e marr, — kundërshtoi. Hyri në bisedë Eshrefi dhe, me një zë lutës, i tha:

— Me gjithë mend e ke?

— Nuk tallem, Eshref, haje ti, pa shiko si je bërë?

Biseda do të kish vazhduar për shumë kohë, po të mos e kishin ndarë copën e bukës në mes. Ish zgjidhja më e mirë. Në këto çaste vura re se si partizani 18 vjeçar përcillesh, po nuk dallova a ndodhte pse i hahej bukë, apo nga që u mallëngjye. Kushedi, ndofta nga të dyja bashkë. U afruan pranë njëri tjetrit dhe, tek ecnin krah për krah, përtypnin atë copë bukë të thatë me aq shije, sikur të kish qenë një franxhollë e ngrohtë, e lyer me gjalpë e mjaltë, dhe qeshnin të gëzuar. Ne, dy të tjerët, i vështronim në heshtje e po aq të gëzuar sa ata, dhe ndjenim në zemër një dashuri të madhe, si të ishim katër vëllezër të një nëne.

Nuk kaluan shumë minuta dhe ajo copë bukë u përtëriti forcat në një mënyrë të çuditshme, sa të dy ja muarën këngës aq të dashur:

*«Prej urisë, prej mjerimit,
katundarë e qytetarë,
nën kushtrimin e Leninit,
partizanët janë të parë...»*

E ruajta të gjallë këtë skenë mallëngjyese për shumë kohë, gjersa një ditë pranvere të vitit 1944 një shok më tregoi diçka që, si të thuash, vulosi për jetë miqësinë partizane të dy të rinjve.

Ja ç'kish ndodhur.

Partizanët luftonin. Tri herë fshati kish kaluar herë në dorë të partizanëve e herë në dorë të fashistëve. Natën e katërt, skuadra ku ishte Eshrefi u dërgua për zbulim. Detyra ishte shumë e vështirë: armiku qëllonte pa pushim, qielli ndriste nga fushqetat e kuqe dhe të gjelbra. Në mes të zjarrit skuadra zbuloi vendin ku genë vendosur mitralozët e rëndë të armikut. Pastaj, duke u tërhequr zvarë në mes të shkurreve, filloi të kthehet te shokët. Befas, anash shpërtheu një batore pushkësh. Nuk kaluan as 30 sekonda dhe vendi u ndez nga bombat e të shtënat e mitralozëve. Eshrefi përmbodhi forcat për të rrëshqitur më shpejt, po ndjeu një tërthur në njëren këmbë, e dhëmbja i shtohet gjithnjë e më shumë. Një plumb i kish shpuar tejprtej kofshën. Nga afër dëgjoi zëra armiqsh. Me automatik në dorë priti çastin e vdekjes. Nga plaga i rridhte gjak. Pastaj forcat e lanë fare dhe, si nëpër mjegull, pa fundin...

Jo, partizani nuk ra në duart e fashistëve. Kur Eshrefi humbi ndjenjat, ju afrua një partizan dhe, me mundim të madh, nën hundën e armiqve, e tërhoqi zvarë gjer në përrua. Kaluan shumë minuta dhe, kur i plagosuri hapi sytë, buzëqeshi. Para tij ai pa Metin e vogël.

Nuk i takova më, nuk di se ku ndodhen, po vetëm për një gjë jam i bindur: kudo që të jenë, sado

larg njëri tjetrit, miqësia e tyre nuk vdes, se ajo u çimentua atje ku njerëzit ndanë çdo gjë së bashku, atje ku filloi një faqe e re e lavdishme e historisë së popullit tonë.

BRESHËRIA E PARË E LAMTUMIRËS

Gusht 1943. Në shkëmbinjtë plot gërxhe rreth Vithkuqit, në tokën e tharë, nën hijet e pemëve të egra e kudo, lufta linte gjurmët e saj të ashpra. Thërmoheshin gurët shekullorë, këputeshin fletët e gjelbra të mareve, shungëllonte vendi nga plasja e predhave të artilerisë fashiste italiane.

Pranë çdo guri, në çdo ledh, në rrëketë e vogla, në mes të të çarave të shkëmbinjve, në vende të mbuluara me drurë apo të zveshura, ballëpërballë me armikun rrihte një zemër e madhe, zemra partizane.

Andej ishin fashistët pushtues, këndej partizanët, bijtë e popullit. Armiqtë ishin dhjetë mijë, të armatosur gjer në dhëmbë, të komanduar nga oficerë me akademi të lartë. Partizanët, disa qindra, pa përvojë luftarake, me nga një dyfek e pak fishekë. Po zemra e luftëtarëve të lirisë u tregua më e fortë se çeliku i armikut.

Lufta është e pamëshirshme. Kosa e saj e vdekjes qendron mbi kokat e njerëzve dhe rrëmben gjënë më të çmueshme, jetën. Po partizanët e jepnin edhe jetën me buzëqeshje. Kjo ishte një

forcë e madhe shpirtërore, që ngrinte peshë zemrat e të gjithëve.

Më kujtohet si tani ajo që ndodhi një pasdite. Ne u mblodhëm në një vend disi të shtruar. Nuk ishim shumë, sepse shokët tanë luftonin pak më tutje. Para nesh ishte trupi pa jetë i një partizani të brigadës. E njoha menjëherë: ishte Petroja, po, Petroja vetë; ai djali me fytyrë të hequr, flokëgështenjë, gojëmbël. Çfarë dhëmbje! Sa çaste tronditëse! Ç'humbje e rëndë! Na dukej sikur vendi ishte i ngushtë, i ngushtë, sa të zihej fryma. Ai nuk jetonte më; një zemër partizane kish pushuar së rrahuri. Ky ishte dëshmori i parë i brigadës sonë. E shihnim të shtrirë, me buzë të ngrira e pak të mbledhura. Shihnim shokun tonë të luftës dhe mendonim. Dëshironim t'i flitnim, t'i futnim krahun, ta merrnim përsëri në luftën çlirimtare, të ecnim bashkë me të në rrugët e provës së rëndë, të ndanim së bashku gëzimet dhe hidhërimet e atyre ditëve, t'u shkruanim prindve letra plot ngrohtësi! Eh, si është kjo puna e dëshirave!

Erdhi çasti që të mos e shikonim më as ashtu të shtrirë, pa jetë. Nuk pati fjalime të gjata, se nuk ishte koha. Po ato fjalë që u thanë buronin nga zemra. Ato ishin fjalë plot hidhërim për shokun e humbur e plot urrejtje për armikun. Kjo e shtonte besimin tonë në fitore. E pastaj, e para breshëri lamtumire. Në ajrin e thatë u përhap jehona e të shtënave të pushkëve tona, që shoqëronte shokun tonë. Lotët na ngrinë në sy. Dikush ja nisi këngës si nëpër dhëmbë, po pastaj ajo u bë e fuqishme. E kishin dëgjuar edhe ata që luftonin aty afër. Ishte kënga jonë, kënga që këndonte edhe Petroja:

*Hakmarrje, rini,
dëshmori thërret,
që ra për liri
në truallin e vet...*

Ne këndonim dhe jehona shkonte larg. Ajo grishte për durim, për vendosmëri, për hakmarrje një popull të tërë, që ishte ngritur në këmbë në luftën çlirimtare.

Sa herë u dëgjua asikohe kjo këngë. Sa filiza të rinj ranë në përleshje me pushtuesit e urryer! Sa nënave ju ngriu loti në sy! Të rënë nuk ishin qindra, po plot 28.000 mijë, një armatë e madhe.

Në ditët e luftës, gëzimi dhe hidhërimi ecin gjithnjë krah për krah dhe lënë mbresa të thella. Dhe nëqoftëse gëzimi i fitores shton optimizmin për fitore të reja, hidhërimi për humbjen e shokut shton urrejtjen ndaj armikut dhe nxit për hakmarrje, për vigjilencë. Njerëzit tanë nuk e kanë zakon të harrojnë shokët e rënë. Kujtesa është një gjë e madhe. Ne do t'i kujtojmë gjithnjë, sepse kështu e ndjejmë veten më të fortë, sepse, nëqoftëse qytetet e fshatrat e shkatërruara rimëkëmbejnë dhe drurët e përvëluar lëshojnë përsëri gjethe në pranverë, karrigia bosh pranë tryezës familjare mbetet gjithmonë bosh.

PARTIA E BËRI NJERI TË VËRTETË

Vjeshtë. Që prej tri ditësh binte shi dhe ne, partizanët, ishim grumbulluar te sheshi para xhamisë së fshatit, duke pritur radhën për t'u ndarë nëpër shtëpitë. Të gjithë ishim lodhur dhe lagur nga shiu. Disa jepnin shenja padurimi, të tjerë përpiqnin për tokë këmbët e qullura, ndërsa ndokush vërshëllente nëpër dhëmbë melodi të njohura të këngëve partizane. Herë pas here shkëputeshin nga grumbulli pesë, a gjashtë shokë që merrnin rrugën e shtëpive, ku i priste të paktën një zjarr i mirë dhe ku do të çlodheshin pas aq orësh udhëtimi nëpër baltë e shi.

Më në fund na erdhi radha. Atë mbrëmje u njoha më mirë me Petritin. Ç'prej asaj nate u lidhëm me një miqësi të ngushtë. Singëriteti dhe thjeshtësia e tij të bënë për vete. Më pëlqente karakteri i tij i çiltër, guximi për të pranuar pa frikë gabimet, po edhe puna dhe vullneti për t'i ndrequr. Ai i urrente armiqtë gjer në vdekje.

Njëherë, pas një lufte të ashpër me gjermanët, kur po çlodheshim rrëzë një kodre, ai u tha shokëve:

— A e dini ç'gjë më ndihmon që nuk ma hedh

dot armiku? Dhe, papritur përgjigjen tonë, vazhdoi:
— Gjakftohtësia.

— Ti, Petrit, nuk e fillove nga kreu, — i tha
njëri nga shokët.

— Ohu, dhe ti, — ja preu ai. — I kërkon gjërat
fije e për pe. Ajo u muar vesh. Po nuk je trim, po
nuk e urrejte armikun gjer në vdekje, s'ke si e
mund, kjo dihet. Këtë na e ka mësuar partia.

Këto fjalë i tha me një zë, në të cilin tingël-
llonte një bindje dhe vendosmëri e madhe.

Partizanët kalonin çaste të vështira, ngrënë e
pa ngrënë, zveshur e zbathur, në shi e në tufan,
po asnjëherë s'e dëgjuan Petritin të ankohej ose
të mallkonte «zotin». Ishte shumë i qendrueshëm
e i papërkulur ky shoku ynë.

Një ditë të ftohtë janari, kur ngrica të thante
këmbë e duar, e pamë Petritin që ecte me një palë
këpucë copa-copa. Shkelte pothuaj zbathur në tokën
e fortë e të ngrirë, plot gurë të vegjël. Duke e parë
ashtu në pikë të hallit, padashur njëri nga shokët
hodhi sytë te këpucët e tij fare të mira dhe ndjeu
një keqardhje, një farë turpi. Deshi t'i jepte një
copë pëlhurë nga këmisha e tij e vjetër, që e mbante
në çantë. Petriti, që po e vështronte me ata sytë e
tij të futur thellë, ja kuptoi mendimin, qeshi me
dashamirësi dhe i tha:

— Eja të ecim një copë rrugë bashkë. Dua të
të tregoj diçka, që ja vlen barra qiranë. Unë të
kuptoj shumë mirë, po më vjen keq që ti nuk më
kupton drejt.

Shoku e ndërpreu me shikimin e tij kundër-
shtonjës, po ai ja tha të gjitha:

— Jam mësuar unë, shok i dashur, me një
jetë shumë të keqe. Përpara se të dilja partizan,

kam bredhur anekënd për të fituar një krodhë bukë. Zotërinjtë janë tallur me mua, më kanë përbuzur, më kanë shtrydhur si limua. Ky kurrizi im mirë që s'u thye nga pesha e rëndë që ka mbajtur. Nuk kisha as strehë ku të fusja kokën, dhe tani, tani që kam pushkën në dorë e jam zot i vetes, tani që kam partinë time, ti kujton se mua më kap dëshpërimi e se po vuaj? Oh, sa gabohe! Petriti i falet njëmijë herë ditës që të gjeti udhën e shpëtimit të vërtetë. Eh, more shok, sikur copë të bien këmbët e mia, unë jam i lirë tani, e kupton këtë, apo jo?

Ne e vështronim nga larg. Shoku ynë na tha më vonë:

— E pashë veten të mundur dhe nuk dita si të çfajsohesha përpara tij. Duket qartë se jeta plot mundime e vuajtje e ka bërë më të fortë se shkëmbi.

Që nga ajo ditë Petritin nuk e pashë më për mjaft kohë. Shkova në një njësi tjetër të brigadës. E takova përsëri kur sulmuam Krujën. Pastaj që më afër njëri tjetrit deri në çlirimin e Tiranës. Sapo u takuam më priti me këto fjalë:

— Gjallë qenke?

— Është ende shpejt për të vdekur, kemi Tiranën e kuqe përpara, apo jo? — i thashë.

Ai psherëtiu dhe foli:

— Nuk di sepse më është mbushur mendja se edhe unë zor të vritem (shkeli syun), sepse trimat nuk vriten lehtë. — Tha këto dhe qeshi me të madhe.

Kur unë fillova ta kundërshtoj, ai u skuq i tëri dhe tha:

— Epo, unë e kam provuar këtë që po të them!

— Ngadalë, shok, se të kapa me presh në duar. Ti ke provuar vetëm njëherë anë, atë të trimërisë...

— Se mos kërkon të kem provuar edhe tjetrën.
— Jo, — i thashë, — po më çudit ajo që ti flet si shumë i sigurtë.

— Thuaj ç'të duash, po këtë që them s'e lot as topi...

Për çlirimin e Krujës luftoi si luan. Arma e tij qëllonte shpejt dhe në shenjë. Më kujtohet si u fut në stallën e kafshëve dhe me automatik në dorë nxori që andej tre gjermanë, që ishin fshehur nën një shtrojë dërrase.

Shpesh herë bisedonim për çlirimin e kryeqytetit dhe ai më thoshte se po të jetë thënë të vritej, dëshironte të binte në rrugët e Tiranës, po, ama, menjëherë nuk harronte të shtonte fjalët: «trimat nuk vriten» e pastaj qeshte me gjithë zemër.

Nuk shkoi shumë dhe lufta ju afrua zemrës së Shqipërisë, Tiranës. Brigada u përhap në afërsitë e qytetit. Poshtë nesh shtrihej kryeqyteti ynë i heshtur dhe hijerëndë. Qindra e qindra sy e vështronin plot gëzim dhe dëshirë që nga kodrat me ullinj. Sa plane hartonin ato ditë partizanët! Ata po trokisnin në zemrën e vendit...

Herë pas here komandat e njëjseve partizane nisnin për në qytet njësitë të vogla, që e godisnin armikun aty ku nuk e priste. Pushka kërciste ditë e natë dhe gjermanët e mercenarët e ndjenin veten shumë ngushtë. Qyteti jetonte në agoni.

Në një nga ato ditët e tetorit të vitit 1944, skuadra e Petritit rrinte në një bregore të vogël të fshatit Babru. Komandanti i kompanisë mbloshi partizanët dhe kërkoi një skuadër për ta ngarkuar me një detyrë të rëndësishme. Ajo duhej të hynte në qytet dhe ta godiste armikun.

Petriti nuk priti, po ju lut komandantit, duke i thënë:

— Jam gati të nisem. Të lutem, mos ma prish këtë herë.

Komandanti e shikoi me vëmendje dhe i tha:

— Të qoftë udhë e mbarë dhe shiko mos u ktheni duarboçh.

— Keni për të parë se do na vejë mbarë gjuetia e derrave, — kështu i quante Petriti fashistët.

Në mbrëmje skuadra u nis. Pas pak u fut në qytet. Petriti me një partizan ecte përpara. Gjarpëruan nëpër ca rrugica dhe dualën në rrugën e gjerë që të çon në spital. Asgjë s'pipëtinte. Vetëm larg dëgjohej një zhurmë e lehtë. S'kaloi shumë dhe skuadra u vu në gadishmëri të plotë luftarake. Zhurma që u dëgjua pak më parë, u bë më e fortë dhe nga larg u duk një autobлиндë, që po afrohej. Disa metra prapa saj ecnin pesë gjermanë me automatikë në duar. Petriti komandoi... Autoblinda kaloi plot zhurmë. Pasi kishte bërë një copë udhë, atë e goditën me bomba. Partizanët zbrazën pushkët. Tre gjermanë u rrokullisën menjëherë. Dy të tjerët u përpoqën të fshiheshin prapa një muri, po plumbat e automatikut të një partizani i lanë të vrrarë pranë murit.

Në anën tjetër të qytetit filloi të dëgjohej mitralozi dhe mortaja. Formacione të tjera partizane godisnin armikun.

Kur u largua skuadra, zhurma e motorave oshëntinte nëpër rrugën e gjerë. Gjermanët mblidhnin kufomat e ushtarëve të tyre të vrrarë.

Po atë natë Petriti i raportoi komandantit për aksionin. Ky e falnderoi:

— Të lumtë, Petrit, qenkeni me të vërtetë gjah-tarë të mirë.

Kalonin ditët dhe në qytet bëheshin gjithnjë përpjekje. Bijtë e popullit paralajmëronin fundin e pashmangshëm të armikut. Në çdo kohë dëgjoheshin krisma mitralozësh dhe pushkësh, plasje bombash.

Petriti u fut edhe shumë herë të tjera në qytet. Pas çdo aksioni kthehej i gëzuar, duke blojtur në mendje plane të reja. I dukej sikur nuk kishte vepruar ashtu siç duhej dhe se, po të kish bërë ndryshe, do të kishte vrarë më shumë armiq. Jetonte i tëri me luftën. Sa herë na takonte, fjalët e tij të para ishin:

— A jeni futur në qytet? S'më pritet sa të marrim urdhërin për sulmin e përgjithshëm.

Kohët e fundit sikur po bëhej i paduruar.

Në fund të tetorit brigada hyri në pjesën lindore të Tiranës. Gjermanët, të lodhur nga goditjet e parreshtura të partizanëve, u mblodhën në qendër të qytetit dhe fortifikuan çdo pikë të përshtatshme për mbrojtje. Gëzimi i partizanëve nuk mund të merrej me mend. Një mori njerëzish dolën për të pritur çlirimtarët e tyre. Të gjithë na shikonin plot dashuri. Burrat na përshëndetnin përzemërsisht, plakat na puthnin duke qarë, ndërsa fëmijët grumbulloheshin e nuk na shqiteshin, duke parë armët tona. Atë ditë ishim aq të gëzuar, sikur kishim fituar çdo gjë. Megjithëkëtë, u deshën plot 19 ditë luftë të përgjakshme që të çlirohej Tirana. U bë luftë për çdo shtëpi, për çdo kat, për çdo rrugë cep në cep. Rrallë kaloi natë pa shpërthyer ndonjë zjarr, pa u hedhur në erë depo municionesh, pa u goditur për vdekje ndonjë çerdhe nazistësh. Hakmarrja e popullit ishte e tmerrshme. Atëhere heroizmi nuk ishte një

akt i rrallë, atë e takoje në çdo kompani, në çdo skuadër.

Petritin e shihja shpesh. Një ditë ai më tha tërë gëzim:

— Do të kërkoj nga komanda që sonte të sulmoj një shtëpi pranë bulevardit të madh dhe t'ua thyej turinjtë atyre derrave, sepse na mërzitën shumë me atë mitralozin e tyre të mallëkuar.

Kur mbaroi së foluri, i thashë se mund të kishte edhe ndonjë të papritur nga ato breshkat e hekurta.

— Po, po, — u përgjigj ai, — e kam parasysh dhe këtë.

E harrova shpejt këtë bisedim të shkurtër me Petritin. Edhe në mbrëmje, në shumë sektorë vazhduan luftime të ashpra.

Të nesërmen e takova rastësisht Petritin. Si gjithnjë, ishte i gëzuar. Biseduam për punët tona, domethënë për luftën. Kur po ndaheshim e pyeta se ku kishte luftuar mbrëmë. Ai e hodhi fjalën gjatë dhe aq bukur, sa ju shmang pyetjes që i bëra. Më vonë një partizan më tha:

— Mbrëmë Petriti mblodhi skuadrën dhe, paşi e shoshiti punën mirë e mirë, u nis bashkë me shokët e tij për të sulmuar një shtëpi ku qenë vendosur ca gjermanë. Kur u afruan, gjermanët qëlluan nga dritaret. Errësira kish mbuluar çdo gjë. Partizanët lëvizën duke u hedhur nga një cep në tjetrin. Në mes të krismave të pushkëve dy nga ata u futën brenda në portën e shtëpisë. Një tjetër kërcëu në dritare. Petriti e vuri re mitralozin armik dhe ju afrua. Plasi një bombë. Pak sekonda më vonë u dëgjua një plasje tjetër. Partizani që ishte futur nga dritarja hodhi dhe ai një bombë. Dy gjermanët ranë në dyshe-menë e ndotur. Ca të tjerë dolën në mes

të tymit dhe të flakës. Petriti qëlloi dhe njërin e rrëzoi për tokë. Nga cepi tjetër i shtëpisë u duk një tjetër gjerman dhe u gjend aq afër Petritit, sa asnjërit nuk i hyri në punë pushka. Filloi një kacafytje e vërtetë. Kur u afruan shokët, e gjetën Petritin si të çakërditur, kurse dy hapa më tutje dergjej i vrrarë nga dora e tij një gjerman. Partizanët ende s'e kishin mbledhur veten mirë kur u afrua një tank. Petriti flaku një granatë. Tanku qëlloi me një breshëri të gjatë, një mur i vjetër me qerpiç u shkërmoq si bukë e thatë. Pastaj nuk u ndie gjë. Skuadra pati vetëm një të plagosur. Goditja mbaroi me sukses.

E pashë Petritin ato ditë aq të bukura pas çlirimit të Tiranës. Në sytë e tij shquhej qartë krenaria e një biri të thjeshtë të popullit, të edukuar nga partia.

KORI ME SHUMË DREJTUES

Mos u çuditni me titullin e këtij shkrimi. Është e vërtetë se, vetëm me të dëgjuar fjalët «kor me shumë drejtues», njeriu habitet dhe pyet në është e mundur kjo gjë.

Po afrohej 24 maji i vitit 1944, dita që hyri në historinë tonë nga ngjarja e madhe, Kongresi i Përmetit.

Në brigadën tonë flitej qysh më parë se atje, në Përmet, do të kishte edhe grupe artistike, që do të jepnin çfaqje. Se si e qysh, asgjë nuk dihei. Sidoqoftë, në një atmosferë luftarake, ku çdo gjë i kushtohej qëllimit të madh, çlirimit të atdheut, këto fjalë kaluan njëherë gojë më gojë e pastaj u shuan fare.

Një ditë, nuk më kujtohet se ç'po bënim, kaloi aty pari komandanti i brigadës. Menjëherë brofëru në këmbë dhe e përshëndetëm ushtarakisht. Ai na vështroi me vëmendje dhe na tha:

— E, si thoni ju, a është e vërtetë se ne të Brigadës I Sulmuese dimë vetëm të luftojmë?

Ne hapëm sytë dhe s'po kuptonim gjë. Komandanti enkas nuk e mbaroi mendimin. Atëhere njëri nga shokët tanë tha:

— Shoku komandant, partizanët e brigadës sonë janë gjithnjë gati të bëjnë atë që kërkohet.

Ai vuri pak buzën në gaz dhe vazhdoi:

— Ja, përshembull, të formoni një kor të fuqishëm, luftarak dhe të jepni çfaqje aty nga dhjetëditshi i dytë i majit. A e bëni dot këtë?

Ne shikua njëri-tjetrin dhe aty për aty e siguroam se do ta kryenim këtë detyrë.

— Mirë atëhere, zgjidhni elementin dhe pastaj të shohim çfarë do të katranosni.

— Kini besim te ne, shoku komandant! Partizanët e Brigadës I, ashtu siç dinë të luftojnë mirë, dinë edhe të këndojnë mirë.

— Do t'ju shohim, — shtoi ai dhe kështu u ndamë.

Brenda një kohe shumë të shkurtër u mblodhëm nga qemë e nuk qemë dhe formuam një kor të vogël në numër (gjithsejt 17 vetë), po aq të fuqishëm, sa që na vajti zëri gjer larg, nga Berati e Gjirokastra. Ishim trembëdhjetë djem e katër vajza. Ditën e parë sikur vumë në provë njëri tjetrin se sa na vlente lëkura. Nuk më kujtohet mirë në çë Hyseni, Luki apo ndokush tjetër që bëri propozimin që kori të kishte katër grupe zërash. Ky mendim na pëlqeu të gjithëve.

Ç'është e vërteta, ne kishim nja dy soprano pak a shumë të mira, tenorë jo të këqinj, ndërsa baritonë dhe basë mjaft të mirë. Disa i njihnin notat, megjithëse asnjëherë nuk kishin pasur partitura përpara.

Ishte fundi i prillit kur na urdhëruan të shkonim në fshatin Starafickë dhe të përgatiteshim seriozisht. Pranvera kishte hyrë mirë. Ajo përtërinte çdo gjë në natyrë. Dhe kjo na frymëzonte për të

punuar me ngulm. Po, që ta themi troç, ajo që na nxiste më shumë, ishte sedra jonë, ajo ndjenjë që i kap njerëzit kur e peshojnë mirë përgjegjësinë. Ne kishim dhënë fjalën se nuk ishim vetëm luftëtarë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, po dhe këngëtarë të mirë.

Shtëpitë ku banonim u kthyen shpejt në qendra të vogla «Shkollë muzikore», ku dëgjohesh kënga revolucionare partizane, e shoqëruar me kitarë, e vetmja vegël që kishim.

Kënga e parë që mësuam ishte «Internacionalja». Te lëndina në mes të shtëpive ajo kumboi fuqishëm ditë me radhë. Asgjë nuk kishte mangut ky kori ynë, përveçse ishte me shumë drejtues.

Kuptohet, dëshira jonë ishte që të paraqiteshim sa më mirë dhe të dilnim faqebardhë, si përfaqësues të Brigadës I Sulmuese, edhe si këngëtarë. Po kush do t'i vlerësonte provat tona, kush do të na i thoshte gabimet e të metat? Ne nuk kishim një drejtues që të harmonizonte zërat tonë, prandaj punën e tij e bënte herë njëri e herë tjetri pjestar i korit. Ja, fjala vjen, dilte nga grupi Hyseni, largohej 10-15 çape e dëgjonte a tingëllonin natyrshëm këngët që mësonim, dhe bënte edhe vërejtjet që i dukeshin të arësyeshme. Pastaj në rolin e drejtuesit dilte Luki, Sava e kështu me radhë. Çdo drejtues tregonte zell të madh dhe dukej sikur ishte me përvojë në këtë punë. Secili mendohej të na i kapte gabimet. Ja, njëri na i ndreqte gabimet kur këndonim «Internacionalen», një tjetër kur bënim provat për dy marshet e Brigadës I dhe kështu edhe për shumë këngë revolucionare shqiptare e të popujve të tjerë që luftonin kundër fashizmit. Të gjithë ju përveshëm

punës me aq pasion, sa që me të vërtetë lodheshim. Fshatarët afroheshin, bënin buzën në gaz, kurse fëmijët nuk na ndaheshin. Ata çuditeshin dhe kënaqeshin pa masë.

Një mbrëmje, në kohën kur po mblidheshim për të bërë një provë tjetër, na thanë se sapo kishte arritur komandanti. U gëzuam, po dhe u merakosëm një çikë kur menduam për «notën» që do të jepte për punën tonë.

Nuk kaloi shumë dhe komandanti u ndodh midis nesh. Pa e bërë të gjatë na «thumboi»:

— Pa të shohim se ç'keni katranosur!

Ne mblodhëm veten; filloi të dëgjohej «të qëruarit» e zërit. Kur u bëmë gati dhe nisëm këngën tonë më të preferuar, «Internacionalen», tërë fshati gjëmoi nga zërat e fuqishëm. Disa partizanë, që ecnin në anë të fshatit, na thanë më pas se qenë çuditur dhe kishin kujtuar se do të ishte ndonjë altoparlant shumë i fortë a diçka tjetër.

Komandanti dëgjoji edhe dy marshet e brigadës sonë sulmuese dhe na bëri me shenjë të pushonim. Ne po pritnim në heshtje «notën» dhe ai e dha me një buzëqeshje shumë të lehtë dhe me fjalë shumë të kursyera. Ky qe një gëzim i madh për ne.

Para se të niseshim për në Përmet, një mbrëmje na vaji mendja për të bërë hallvë. Dikush nga ne shtoi se ajo i bën mirë zërit. Kishim gjalpë e miell, po na mungonte sheqeri. Pasi e gjetëm edhe këtë, hëngrëm një kusi të madhe plot hallvë. Pastaj na sollën të rejat e luftës dhe fitoret e partizanëve anekënd atdheut. Kjo na gëzoi pa masë.

Pas ca ditësh u nisëm për në Përmet. Rrugës qendruam në një fshat, ku ishin edhe ca shokë me

përgjegjësi. Këtu bëmë një provë tjetër, që pati shumë sukses.

Ato ditë Përmeti ngjante me një kamp ushtarak. Nga ana e anës vinin delegatët. Aty bëmë provën e fundit. Ishim të gëzuar, por ngazëllimi ynë u zbeh për një çast. U bë një propozim që kori ynë të bashkohej me një kor tjetër të madh prej 50-60 vetësh. Ne nuk pranuan. Sedra na shtynte të tregonim se dinim edhe të këndonim mirë. Dhe kështu u bë. Na lanë si kor më vete.

Gjatë punimeve të Kongresit dhamë një çfaqje të bukur, që përmbante, përveç pjesëve të korit, edhe ca skena teatrale me temë nga aktualiteti, si dhe një melodramë. Suksesi ishte i plotë. Tërë salla duartrokiti nxehëtësisht. Dhe ne ndjenim një kënaqësi të madhe, se e kryem me nder një detyrë të re dhe çuam në vend urdhërin e komandantit. Duke dalë nga salla, një nga delegatët i tha shokut përmbri:

S'ke ç'i thua, partizanët e Brigadës I Sulmuese nuk dinë vetëm të luftojnë, po edhe të këndojnë.

Shoku ynë, që i dëgjoi këto fjalë, buzëqeshi dhe instinktivisht vështroi pushkën e tij, pastaj vëshëlleu lehtë marshin e Brigadës I Sulmuese.

DITARI

Në çantën e Piros do të shikoje dy gjëra: ndërresat dhe një ditar. Ky ditar kishte ngjallur diskutime, madje i kishte bërë partizanët «të ndaeshin» në dy grupe. Në të parin, që ishte më i madhi, futeshin ata që e çmonin drejt këtë punë të shokut të tyre. Në të dytin bënin pjesë të tjerët, që e shihnin këtë si diçka pa vlerë e që, veç andrallave, s'hynte hiç në punë.

Piroja nuk linte gjë pa shkruar në ditarin e tij. Kur shokët merreshin me gjëra të tjera gjatë kohës së lirë, atë do ta shikoje me ditarin në dorë. Kishte hokatarë që s'u rrihej pa e ngacmuar e pa i hedhur lloj-lloj thumbash. Një ditë, tek po pastroinin pushkët, njëri nga partizanët i tha:

— E, Piro, si e ke me shëndet «Ditarin»; s'po e shohim, si duket edhe ty të mbiu në sy.

Të tjerët ja plasën gazit.

Piroja ngriti kokën dhe nisi t'u mbajë një goxha leksion për rëndësinë e ditarit. Megjithëkëtë, ata e ndërprejnë me lloj-lloj shakash, po ai i detyroi prapë të dëgjonin argumentat e tij.

Njëherë, kur partizanët ndodheshin ngushtë me ushqim, Ibrahim i thumboi rëndë duke i thënë:

— E, si thua, a e këmben tani ditarin tënd me një copë bukë misri të ngrohtë dhe me një copë qepë të madhe?

Piros ju mbajt ca goja, po pastaj s'e përmbajti veten dhe e shau vençe.

Kaluan kështu disa muaj dhe filloi të ndërrojë mendimi i atyre që nuk e çmonin rëndësinë e ditarit. Piroja e vinte re këtë ndryshim dhe gëzohej. Megjithëkëtë, kishte nga ata që s'hiqnin dorë nga mendimi i tyre dhe vazhdonin ta ngacmonin. Një natë, pesë partizanë, midis të cilëve edhe Piroja, ranë për të fjetur në shtëpinë e një fshatari. Kur i zuri gjumi të gjithë, njëri nga ata u ngrit dhe, duke ecur lehtë-lehtë, shkoi gjer te çanta e Piros, futi dorën brenda, mori ditarin, u kthye tek vendi i tij dhe u shtri për të fjetur.

Të nesërmen, pasi hëngrën një copë bukë e u bënë gati për udhë, u dëgjua një zë i vrazhdë që thirri:

— Asnjë të mos lëvizë nga vendi!

Piroja kishte zënë portën dhe u tha të katër shokëve që të mos e zgjatnin shumë, po t'i jepnin ditarin që ja kishin «vjedhur». Tre nga partizanët bënë be e rrufe se, jo që nuk ja kishin marrë atë të mallkuar ditar, po as që çanin kokën fare për atë «pasuri» të tij të luejtshme. Mirëpo ku të linte Piroja të kaloje prakun!

— Nuk keni për të luajtur që këtej, po nuk më dhatë ditarin.

Piroja e kishte mbuluar portën pothuaj fare me atë trupin e tij të madh dhe nuk u lëshonte udhë. Atëherë njëri ju kthye Asllanit e i tha;

— Asllan, jepja atë drej ditari, se nuk e sheh

se po na rri si ai qiklopi, gati për të na shqyer?

Asllani filloi të qeshë. Piroja s'priti më, po u lëshua mbi të e ja rrëmbeu çantën dhe e bëri lesh e li, po nuk gjeti gjë. E lëshoi çantën vetëm kur Asllani, duke qeshur me të madhe, e nxori ditarin nga gjiri. Kështu e shpëtoi Piroja edhe kësaj radhe ditarin e tij.

Kaluan ditët edhe shokët filluan dalngadalë të hidhnin sytë te ditari i Piros, për të vërtetuar se si kishte rrjedhur një ngjarje apo një tjetër. Piroja e ruante ditarin e tij si sytë e ballit.

Një ditë, pas shtëpisë së një fshatari, ishin mbledhur kokë në kokë nja dhjetë partizanë dhe po haheshin. Njëri ngulte këmbë se në Tendën e Qypit, ditën e dytë të luftimeve, kish sulmuar e para kompania e dytë. Dy të tjerët e kundërshtonin. Nuk ishin të një mendimi edhe për numrin e maqinave të shkatërruara nga partizanët në aksionin e Xhyrës, si dhe për robërit fashistë që ishin zënë. Në mes të të thirrurave pohuese e mohuese, u dëgjua një zë:

— Sa budallenj që jeni, shpejt silleni këtu ditarin e Piros dhe ndahet shapi nga sheqeri!

Të gjithë qenë të një mendimi. Kur e thirrën, Piroja kish kujtuar se po talleshin, po pastaj, kur i pa ashtu grumbull, e kuptoi se ditari i tij po fillonte të merrte frymë dhe të çmohej. Ai e nxori nga çanta e shpinës, e shfletoi me kujdes dhe ato që kish shkrojtur e bënë punën e tyre.

Njëherë tjetër partizanët e kompanisë së Piros kapërcyen një përrua të rrëmbyer. Disa kapeshin për dore ngaqë rrëshqisnin kur këmbët u ndeshnin në gurët e lëpirë në fund të ujit. Të tjerët qeshnin kur ndonjë shok e humbiste drejtpeshimin e përplasjes në ujë. Çanta e Piros, bashkë me të zotia,

pati edhe ajo këtë fat. Piroja u ngrit shpejt, po çanta «lundroi» shumë. Ai u pikëllua sidomos kur pa ditarin e tij që kish dalë nga «mburoja» dhe po notonte. U muar me të gjersa e kapi, pastaj e thau mirë, por ca fletë qenë bërë njolla-njolla. I grisi ato dhe i zëvendësoi me të tjera, që i qepi me durim të madh.

Erdhën ditët kur shokët nisën t'ja kërkojnë gjithnjë e më shpesh ditarin, po Piroja nuk ua jep-te kurrë në dorë:

— E shfletoj unë dhe ju lexoj ç'të doni, vetëm mos ma kërkonit se nuk e lëshoj dorë më dorë, — u thoshte ai.

... Partizanët po merrnin frymë pas një sulmi të ashpër. Piroja e kishte vënë çantën në tokë, aty pranë një trangu peme. U dëgjuan edhe një herë ca krisma të veçuara pushke. Disa nga partizanët dalluan një skuadër nazistësh që po përpiquej t'i ngjitej kodrës nga krahët. Shpërtheu përsëri sulmi kundër tyre. Piroja u rrëmbye aq shumë nga luftimet, se i doli në shteg armiku, sa që e harroi fare çantën. Pasi qenë larguar mjaft nga vendi, u kujtua për gabimin. Dy shokë, bashkë me të, u nisën për ta kërkuar. Në këtë kohë u dëgjuan sokëllimat e «sharrësve» gjermanë, plasën bomba. Armiku po kundërsulmonte...

Kur u kthyen te shokët, Piroja, që ishte mbytur në djersë, po që shkëlqente në fytyrë nga gëzimi, i priti me kënaqësi kritikën e të tjerëve. Ai kishte me vete ditarin e tij të çmuar.

Ditari i Pirosh hyri në historinë e kompanisë. Atë e shfletonin, natyrisht me dorën e Pirosh, dhe e ruanin gjithë partizanët.

Pas çlirimit nuk pata rast ta pyesja Piron për ditarin e tij. Kjo fletore e zverdhur, me kapakë ngjyrë qielli, i kapërceu vështirësitë, «luftoi» bashkë me partizanët dhe pastaj u çlodh diku, për të shërbyer gjithnjë me të dhënat e saj të çmueshme.

DY SHOKËT

Ishte nga Meçani i Gorës. Erdhi partizan që me formimin e Brigadës I sulmuese. Shokët e njohën në atë fushën e blertë të Makrenzës të Vithkuqit, ku u bë inaugurimi i saj më 15 gusht 1943.

E quanin Gani. Ky fshatar i thjeshtë kishte etje të madhe për të mësuar. Për këtë, nganjëherë bëhej edhe një çikë i mërzitshëm. Sidoqoftë, Ganiu nuk hoqi dorë kurrë nga dëshira e tij e madhe.

Njëherë, ndërsa gjithë shokët i kishte kapur një gjumë i thellë, pas një lodhjeje të madhe, kish le-xuar gjer natën vonë. Të zotit të shtëpisë i kishte bërë përshtypje kjo gjë. Të nesërmen në mëngjez, kur Ganiu doli nga shtëpia, ai pyeti partizanët e tjerë:

— More djema, kush është ai që sapo doli me atë pushkën gjermane?

— Pse, xhaxho, kishe ndonjë gjë për të thënë për të?

— Jo, jo, po ai duhet të jetë pa tjetër komisari, se tërë natën (siç e shihni, e zmadhoi) ka kënduar ca letra.

Shokët qeshën dhe që nga ajo ditë Ganiut i mbeti epiteti «komisari». Dhe sa herë i thërrisnin

kështu, vinte buzën në gaz dhe nuk e merrte për të keq.

Komisari i kompanisë, ku bënte pjesë edhe Ganiu, ishte një djalë rreth 22 vjeç. Kishte fytyrë të hequr me tipare të rregullta dhe, me fjalën e tij joshëse, po gjithnjë bindëse, të bënte për vete. Ai kishte një «telash»: kudo që shkonte, mbante në çantën e tij me rripa të gjatë, përveç të tjerave, dhe një sasi të mirë librash të ndryshme, shumë të dobishme për edukimin e partizanëve. Ganiu i ishte bërë «ferrë» dhe gjithnjë do të rrëmonte në çantën e tij dhe do të merrte herë një libër e herë një tjetër për ta lexuar. Komisar i nuk ja prishte asnjëherë, ja plotësonte dëshirën dhe Ganiu e falnderonte me një buzëqeshje të përzemërt.

Një ditë, partizanët po i ngjiteshin një të përpjete. Nga fytyrat u kullonin pika të mëdha djerse. Qenë lodhur sa s'ka duke u ngjitur, po maja s'po dukej. Komisar i mundonte ajo e shkretë çantë me tërë atë peshë. Rripat e saj i prisnin qafën dhe ai detyrohej ta hidhte herë në një krah e herë në krahun tjetër. Disa metra larg tij, pas nja pesë a gjashtë shokësh, ngjitej Ganiu. Ky vuri re se komisar i mezi çapitej për shkak të ngarkesës që mbante. Shpejtoi me hapa të mëdha si të ariut dhe, kur u ndodh fare pranë, dëgjoi një nga partizanët që i tha komisarit:

— Shoku komisar, kjo çanta ta nxori shpirtin me këta rripa. S'është punë kjo, po flake njëherë e mirë që të shpëtosh përgjithnjë.

Partizani ende nuk i kishte mbaruar mirë fjalët e fundit, kur Ganiu ja preu tërë seriozitet e duke gulçuar!

— Ta hedhësh çantën me tërë ato libra! Je në vete ti, apo si! — Dhe duke ju drejtuar komisarit e duke i rënë çantës me dorë vazhdoi: — Hiqe shpejt nga krahët, se kjo e ka vëndin këtu... — Dhe tregoi qafën e tij të shëndoshë që skuqte si prushi.

— Dëgjo, Gani, — desh të kundërshtojë komi-sari po ai e ndërpreu dhe i tha:

— Mos folë, do ta përcaktoj unë si do të bëjmë dhe cilat do të jenë «detyrimet» e të dy palëve. Në çdo të përpjetë çantën do ta mbaj unë, kurse në të tatëpjetat, po deshe mbaje vetë.

— Ti e bën këtë si komisar që jam, apo jo? — tha ai dhe u shkeli synë shokëve.

— Jo, mor, jo e di mirë ti. Në radhë të parë sepse më dhimbset ajo që ka çanta brenda. Është ushqimi ynë aty. Mos bëj sikur s'di gjë. Pastaj ç'të keqe ka këtu? Jemi shokë, apo jo? Dua të të ndihmoj, mor derëbardhë, se je i dobët e s'mban dot veten e jo më këtë peshë të madhe që ka këtu brenda.

Pas kësaj ngjarjeje, Ganiu e fitoi davanë. Vetëm se ai «e bezdiste» komisarin, duke kërkuar të shtonte fondin e librave dhe t'i tregonte gjëra interesante për luftën revolucionare, ndonjë gjë për Stalinin, për heroizmat e ushtarëve të kuq, etj. Sa për çantën, problemi u zgjidh në interes të të dy palëve...

Ganiu, që i donte shumë të gjithë shokët, kishte shoqëri të madhe, përveç me komisarin, edhe me një partizan tjetër, që e quanin Teki. Të dy ishin nga një krahinë. Edhe Tekiu ishte fshatar, po një

çikë më i mësuar. Shoqëria e tyre u farkëtua në zjarrin e luftës. Siç ngjet shpesh, edhe këtyre të dyve u qëllloi të japin provën më të madhe për shokun shokun. Ja çfarë ndodhi.

Në njërën nga luftimet e shumta të kompanisë, përpjekja me nazistët u fut në një rrugë, ku u përzier partizanë e gjermanë dhe nuk kishte më një vijë të qartë pozitash. Tekiu qëllonte në njërën krah, nga ku godiste një mitralier armik. Duke u tërhequr zvarë, ai u fut në një shteg të ngushtë. Donte me çdo kusht ta qëronte atë mitralier të mallkuar. Siç duket, nuk e përfilli fare rrezikun që mund t'i kanosej. Pasi doli në një ledh të ngritur, u mbështet pas një dëllinje dhe, me granatë në dorë, vështronte përpara. Në atë çast mitralozi gjerman qëllloi përsëri. Tekiu s'luajti nga vendi. Granatën e shtrëngonte në dorë aq sa i dhëmbnin gishtrinjtë. Syri i tij i stërvitur e pa më në fund armikun dhe në çast ajo masë hekuri fluturoi me forcë e plasi disa dhjetra metra më tej. Po, a i rrihej atij pa parë efektin e saj? Prandaj u ngrit për gjysmë. Papritur, një derro gjerman, dy metra i gjatë, fare afër, ngriti parabelin dhe... U dëgjua një krismë e fortë. Tekiu mbeti si i ngurrosur në vend. Ktheu kokën dhe pa atë alamet trupi që ra si lis i këputur në mes, me revolverin në dorë. Ç'kishte ndodhur? Ganiu, i cili e kishte ndjekur shokun në çdo lëvizje, qëllloi më parë se gjermani. Ai ja njihte dobësinë shokut. Pas pak u larguan të dy pa bërë zë dhe ishte Tekiu që e tregoi ngjarjen, duke «thyer» fjalën e dhënë shokut. Sa për Ganiun, ai asnjëherë s'e zuri në gojë këtë episod.

Kaluan javët e muajt dhe erdhi 20 janari 1944. Partizanët e Brigadës I luftonin në Tendën e Qypit, përballë Çorovodës. Në njërën nga të katër ditët e luftimeve fytyfyt, disa partizanë, midis të cilëve të dy shokët, ngjiteshin për në pozicionet e nisjes, drejt majës. Ata e kishin detyruar armikun të tërhiqej, pas një luftimi shumë të ashpër, nga i cili disa gjermanë kishin mbetur të shpërndarë e të çakërdisur në zonën ku vepronin partizanët.

Ecnin në njëshkolonë, në largësi 7-8 metra njëri nga tjetri. Në krye ishte Ganiu. Edhe pak e do të errej. Partizanët ngjiteshin pa zë, të lodhur, po të gëzuar që i kishin thyer gjermanët. Vendi ishte plot shkurre të vogla. Nuk shihej asnjë rrugicë që të tregonte shenja nga ku mund të kishin kaluar njerëz. Tekiu mbyllte kolonën e vogël partizanë. Papritur u dëgjua një krismë e fortë arme, dhe një britmë. Disa sekonda qetësi. Pastaj partizanët u përhapën në formacion luftimi. Tekiu u sul si vetëtimë përpara, se diç dalloj në atë britmë. Ju bë si zëri i Ganiut. Nuk kaloi shumë dhe u dëgjua një krismë pushke djathtas. Pastaj shokët e panë Tekinë që po qante. Nuk ishte në gjendje as të fliste, vetëm tregonte me dorë në drejtim të një shkurreje të vogël, ku shtrihej pa jetë shoku i tij. Nazisti, i fshehur aty pranë, në pamundësi për të ecur, kur pa se partizanët po vinin në drejtim të tij, kishte ngritur parabelin dhe kishte qëlluar mbi të parin. Dhe ky i pari ishte Ganiu ynë.

E gjetëm pa jetë shokun tonë, me çantën që ishte hapur, nga ku kish rënë përdhe një libër. Kur

e shfletuam, vumë re nënvizimet që kishte bërë Ganiu dhe u prekëm më tepër. Disa hapa më tutje shtrihej nazisti me dy plumba në trup, nga të cilët njëri i kishte thyer këmbën e djathtë, kurse tjetri, ai i Tekiut, i kishte shpuar tejprtejt gjoksin.

PASOËT E LINDJES

1	Lexuarve
2	Nazim
3	Nis dorë melli
4	Shporet lona të lullit
5	Njëshkollon parullave
6	Gjyft i detyr në larmë
7	Trokit
8	Prind shokëve të tjerë
9	Në burg
10	Palet e të vjetërës
11	Dëmtimet u krenë
12	Mistotit
13	Liqihart duarë lëndit
14	Hura e për me shok
15	Luftëtarit e parë e lamtumirës
16	Paritë e për detyr të vjetërës
17	Kort me shokë detyrës
18	Ditari
19	Dy shokët

PASQYRA E LËNDES

Lexuesve	5
Zemra	7
Një dorë miell	13
Shoqet tona të luftës	18
Njëshkolona partizane	24
Qyteti i djegur në festë	30
Trakti	35
Pranë shokëve të rënë	40
Në burg	45
Fjala e së vërtetës	52
«Damarët» u prenë	56
Misioni	59
Lapidari buzë liqenit	65
Buka e lyer me gjak	69
Breshëria e parë e lamtumirës	75
Partia e bëri njeri të vërtetë	78
Kori me shumë drejtues	86
Ditari	91
Dy shokët	96